

LIBRI

I OREVE TË MËDHA

në

KRISHTLINDJE ,THEOFANI'

e tek e PREMTIA E MADHE

Botoi MONDO ALBANESE te Sklitsa
Hora e t' Arbëreshëvet 1984

Η ΧΡΙΣΤΟΥ

ΓΕΝΗΣΙΣ



te dita më para se

K R I S H T L I N D J A

ORA E PARE

Bekuar kloft Perëndia jinë përherë
nani e gjithëmonë e për jetë të
jetëvet . Amin .

Lëvdi Tij, o Perëndi, lëvdi Tij .

Rregji i kjelellës që na përgëzon,
Shpirti i së vërteties që je gjithasajtën
e që gjithkujsh mbëlon ,
vistar i së miravet që gjellë dhuron,
eja e rri me ne , pastrona nga
çedò mëkatë e ruajna , oi Mireth,
shpirtrat t'anë .

Krishtlindja - ORA e PARE

TRISAJON

Lëvdì past ...

Trini gjith'e shejte ,paçe
lipisi për ne; ijëna afër te
mekatët t'ona, o i Zot, na ndë-
jë fajet t'anë; eja, o i Shejt
e na shëndosh ligështin t'ë-
në paj t'emërit t'it.

Lipisi... Ati i jinë...
Se jotia isht rregjëria ...

Lipisi ... Lëvdì past...

Ejani t'i falemi e t'i përmisemi
Mbretit t'ënë Perëndi.

Ejani t'i falemi e t'i përmisemi
Krishtit Perëndi e Mbreti jinë .

Ejani t'i falemi e t'i përmisemi
Atij vet ,Krishtit Mbret e Perën-
dia jinë .

Krishtlindja - ORA e PARE

Ms. 5

Vëri veshin fialëvet t'ime, o Pe -
rëndi: kuptoje psherëtimin t'im.

Ndëlgoje zërin e lulis s'ime, o
Rregji jim e Perëndia i jim, se u
Tij të lutem, o Perëndi.

Menatnet Ti më gjegje zërin t'im,
menatnet dua të t'vuhem përpara e
dua të Të shoh .

Se Ti ngë je Perëndi që do të ke-
kjien ; ngë isht me Tij ai që bën
të ligën.

Të likjët ngë mëndë të rrin përpa-
ra sivet t'atë; Ti i ke mbëri gjithë
atireveçë bëjën të kekjien.

Ti mënd'e sbiren gjithë ata që
thonë të rremen: burrit gjakësuar
e gënjeshtar i sihjenet Perëndia.

Krishtlindja - ORA e PARE

Por u paj të lipisis tënde shumë të madhe ka t'hinjë te shpia jote, ka t'përmisem Tij përpara faltores t'ënde së shejte me trëmbësirën t'ënde.

O Perëndi, kjellëmë te drejtësia jote për armikjët t'imë: ndrekjëmë dhromin përpara Teje .

Se te goja e 'tire ngë isht e vër-teta e zëmbra e 'tire isht e pris - shurë: varr i sbëllim grika e 'ti - re : me gluhët e 'tire gënjejën.

Gjikoi Ti, o Perëndi, le të bien nga dredhët e 'tire: përsa janë të më-dha ligësit e 'tire Ti përzëji, se egërsuan Tij, o Perëndi .

E le të gëzonen tek Ti gjithë atë që shprejën mbë Tij: gjithëmonë ka t'ken harë e Ti ka t'jetësh tek atë;

Krishtlindja ORA e PARE

E kanë të lëvdonen mbi Tij gjithë ata që duan mirë embrin t'ënt .

Se Ti ka t'bekosh të drejtin o Perëndi, ashtu si na pështrovene-ve me mburonjën e butësis .

Ms. 44

Buron zëmbra jime të folë të mirë: u dua t'thom Rregjit veprat t'ime.

Gluha jime si një kallëm shkruesi që po shkruan shpajt.

Ndë bukuri Ti je më i hjleshmi se të bijët e njerëzëvet .

T' u detth hir mbë buzët t'ote; andai të bekoj Perëndia për gjithë monë .

Krishtlindja - ORA e PARË

Var rreth mbë ijë shpatën t'ënde, o i mëndëm.

Ndeje harkun, shko përpara, përparò e rregjërò.

Paj të së vërtetës e të butësis e të drejtësis, dhe e drejta jote ka të të udhëheqjën një bukur.

Të mprehta janë shigjetat t'ote; përposh teje ka t'bien popujit; atò ka t'ngulen te zëmbrat e armikjëvet t'atë.

Throni jit, o Perëndi, do t'jet për mot monë; shkopi i rregjërës t'ënde ë shkop drejtësie.

Ti deshe drejtësin e urrejte paligjësin; prandaj Perëndia të përlyejti, Perëndia i jim, me vaj gëzimi mbi shokët t'atë.

Krishtlindja - ora e parë

Gjithë të veshurat t'ote bëjën erë smirne, aloe e kassie; në odhët të eburta një këndim të gëzon zëmë-rën.

E bija rregjërash të vijën përpa - ra sa të t'nderojën e të gëzojnë .

E tek e drejta jote rri rregjërë - sha e veshurë me ar, gjith'e stoli - sme.

Gjekj, Bijëzë, e shih e mirr 've - shë e harrò gjinden t'ënde e shpin e t'it eti.

E Rregji ka të dishironjë bukurin t'ënde, pse Ai isht i zoti i jit e Atij ka t'i falesh përmist.

E vashëzit e Tirës do t'vijën me dhuretë e fitirës s'ate do t'i lu - ten gjithë të kjosmit e jetës.

Gjith'e lambarisme me lëvdi ë brënda Palatit e Bija e Rregjit; i këndisur me ar ë mënti i 'saj .

E prapa asaj do t'venë përpara Rregjit t'jerë virgjëresha ; ka t'jen kjellur Tij gjitonet e 'saj .

Ka t'jen kjellur me gëzim e me harë ; do t'jeq kjellur te faltoria e rregjit .

Në vend t'atëravet t'atë t'u kanë ler bijët : do t'i vësh të urdhurojën gjithë dheun .

Do t'kujtojën ëmbrin t'ënt në çëdë jini .

Prandaj popujit ka të t'lartësojën në jetë e në jetë të jetëvet .

§§§§§§§§§§*****

Ms. 45

Perëndia isht pështrimi jinë, fukjia e ndihma te helmet të tepërmë te të çilët ndodhemi .

Prandaj ngë trëmbemi as në shkundet dheu e malet ven'e sosiën në fund të dejtit .

Ujërat e 'tire gjëmuan e u shkundën; u shkundën malet me fukjin e 'tij .

Vijët e lumit do t'gëzojën kjitetin e Perëndis ; shejtëroi ndenjen e 'Tij in'Zot .

Perëndia ë në mes të 'saj; atë do t'e ndihënjë in'Zot çë kur bën ndritçullë .

U shkjetësuan kombet, rregjërit dridhen; i Larti dha zërin e 'tij e dheu u tund,

Krishtlindja - ORA e PARE

Zoti i fukjivet ë me ne mbron-
njësi i jinë , Perëndia i Jakobit.

Ejani e shihëni veprat e Perëndis,
çudhit që ka bër mbi jetën tue bër
të sosiën luftat njer në kufimet e
dheut.

Do t'çanjë harkjet ,shtizat do t'i
bënjë tsopa tsopa e do t'djegënjë
me zjarr kjerret e luftës.

Mbani e pranoni se **U jam Perën-
dia.** Do t'jem lartësuar ndër kom-
bet , do t'jem lartësuar mbi dhet.

Zoti i fukjivet ë me ne,mbronjësi
i jinë , Perëndia i Jakobit .

lëvdi past ... aliluja(3) lipisi,
o Zot (3) lëvdi past ...

U shkrua ahierna bashkë me pla-
kun,se nga fara e Davidhit , në

Krishtlindja - ORA e PARE

Vithleëm Mariam tue kjellur në gjí
të zënin pa farë. Jerdhi koha e të
lerit e vend ngë u ndoth te bujto-
ria.Po si Palat i bukur Mbretëre-
shës ju duk shpella. **Krishti lehet**
atë më parë e rarë sa t'ngjallënjë
fitirë.

nani ...

Si ka të t'thresiëm,o e Hir-plo-
ta ? Kjell ? SE **ngrejte** Diellin
i drejtësis ? Parrais ? Se
dhe lulen e paprishëris ?
Virgjëreshë ? SE MBETE E pa-
prishëshme ? Mëmë e dëlirë ?
SE PATE TE GJIRI JIT Birin ,
PERENDIN I GJITHEVE ? Atij lu-
tu të shpëtonjë shpirtrat t'anë .

Krishtlindja - ORA e PARE

g*****

i d h i o m e l a

(të Sh. Sofroniit t'Jerusalimit)

Përgatitu o Vithleëm, grazhdi le t'bënet gati e shpella dëftoft mirëpritien e 'saj. Jerdhi e Vërteta, shkoi e vate hjeja . I ler nga një Virgjërë i dëftonet njerëzëvet Perëndia, i bër si na, po që hjynizon naturën e njeriut që mori. Andai Adhami ë përtërijtur me Evën e të dy thërresiën: U dëftua mbi dhet pëlkjimi i t'in'Zoti sa të shpëtoj jinin t'ënë .

Perëndia ka vinjë nga Themani e i Shejti nga mali i hjesuar nga pylli. 5(Habakuk)

Nani mistikjisht isht e mbaronet profetsia që thot:"Ëti Vithleëm,dhe

Krishtlindja - ORA e PARE

i Judhës , ngë je më e vogëla e zotëri-
vet ti që je përgatit shpellën,
përçë isht e më vien ngah ti në kurm
Kjiverrtari i gjithë kombëvet,Krish-
ti Perëndia jinë ler nga Virgjëra.

Ai ka t'kulotënjë popullin e 'tij
Israelin i ri. Të gjithë t'E madhë-
rojëm.

lëvdi ... nani ...

Kështu foli Josifi Virgjërës: që
isht e streks tek Ti , që shoh u ?
Famasem,skotisem,jam marr mendsh!
Andai fshihu sa më njize ngak u .
Çë isht e streks tek Ti,çë shoh u?
Në vënd NDERI dhunë; në vend gë-
zimi lip; në vend lëvdie kjërtime.
Ngë mendë të duronj u të sharat e
njerëzëvet! Nga priftrat e Falto-
res të mora si e papërlyeme përpa-
ra t'in'Zoti , e që shoh nani ?

Krishtlindja - E PARA ORE

Perëndia më tha mua:im Bir je Ti,
U sot Tij të kam ler .

Ti mua lipënë , e U kam të
t'jap Tij trazhgimin t'ënt
gjindet , e të pasurën t'ënde
këndet e dheut .

nga Profetsia e MIHJËS

(v.1-3)

Po Ti Vithleëm e Ifrathàs,
ngë je më e vogëla ndër mijëra për-
çë ngah Ti ka t'dlnjë Ai çë ka të
kjëvarrisënjë IsrAelin .Përyardhia
e 'Tij nga të zënit fill,nga ditët
e përjetësis.Përandaj Perëndia do
t'i lërenjë njer çë Ajo çë ka tëln-
lindënjë të na japënjë të Vogëlin.

Ahierna gjithë t'jerë vëllezër do t'prien
te Israeli. E in'Zot ka t'mbetet,
ka t'jet par e ka t'kulotënjë gri-
gjen e 'tij me fukjil e me madhësh-

Krishtlindja - ORA e PARE

tin e enbrit t 'Tij ata do t'mbeten
përçë nani do t'jen madhëruAr njera
te të sprasmitë kënde të Botës .

NGA litra e Shën palit

Ebrenjëvet I,1-12 .

Perëndia,pas të foluri shumë
herë e me shumë viershe Atëravet t'
anë pr'anë të Profetravet,te këtë
sprasme ditë na foli pr'anë te Birit
të çilin vuri trazhgimtar të të gj-
thave. Pr'anë të 'Tij Ai bëri edhe
jetët. I çili Bir ,tue klënë për-
thimi i lëvdisë e mresa e të klënit
t'Tij,kjeh gjithkjish me fialën e
fukjil s 'Tij.

Pas të pastruari mëkatët t'ona u
uj tek e drejta e madhëris s'Tij te
më i larti kjell. Edhë akjë më si-
për u bë se Engjëjitë se Ai trazh-

Krishtlindja - ORA e PARE
\$\$\$\$\$\$\$\$*****

goi më të shkëlqjemin ëmër .

Kuji nga ëngjëjitë i tha kur: Ti je jim Bir , sot U të leva ? E pra: U ka t'i jem AT e Ai ka të më jet BIR ? Kur pra udhëhekjës të Paralindur in te jeta, thot: E gjithë ëngjëjitë e Perëndis le t'i bien për-mist . E përëngjëjitë thot: Ai që bëri frima ëngjëjitë e 'tij e shërbëtorët e 'tij flaka ziarri.

E të Birit pra thot: Throni i jiti Perëndia në mot monë: shkop drejtërie, shkopi i rregjër is t'ënde. Deshe drejtërin e urrejte paligjësin; pran-daj të lyejti Perëndia, Perëndia jiti, me vaj gëzimi në vend të shokëvet t'atë. ETi , o Perëndi , në të zënit fill stise jetën e vepra të duarëvet t'ote janë kjielliat; atë ka t'humben, po Ti ka t'kjëndrosh; gjithë si pethka ka t'vietronen e si të veshura ka t'i pështiëllësh atë

Krishtlindja - ORA e PARE

e ka t'ndërronen, po Ti je gjithë-mo-në Ai e vietçët t'atë ngë ka t'sh-kojën . "

VANGJEJI Mat. 1, 18-25

v. f. 188

Ms. 118

Ndrekjë hapet t'imë si do fiala jote, e mos më mundëshit çedë paligjësi.

Liromë nga të shpifurit e njerëzëvet sa u të ruanj urdhurimet t'atë.

Dëfto fakjien t'ënde shërbëtorit t'ënt e mësomë të drejtat t'ote.

ms. 70/: U mbufshit goja jime me të lëvduarit Tij sa u të këndonjë lëv-din t'ënde; gjithëditën të nderonjë madhërin t'ënde.

Krishtlindja - ORA e PARE

Trisajon - Trinl gjith'e shejte
Ati jinê - Se jotia isht rregjêria

kondakjion

Virgjêresha sot në shpellê
vien për lindien e pathënësh-
me e të paramotshmes FIALE.

Bëj harê, o jeta e gjithë ash-
tù si e gjegje. Lavdërò bashkë
me Engjëjitë e me delmerët të
paramotshmin Perëndi, se deshi
t'ishë par si Dialë i ri .

Lipisi, o Zot (40)

O Zoti Krisht Perëndi që në çdò
kjërò e orë je i përmisur e i lëv-
duar në kjiell e në dhe, o shum'i li-
pisiar, i mirë e zëmërenjomë; që do
mirë të drejtitë e ke lipisi për të
mëkatruamitë. Ti që thërret gjithë-

Krishtlindja ORA e PARE

njerl të shpëtonen tue taksur të
mirat të ardhshme, Ti, o Zot, prit mi-
rë lusit t'ona te këjo herë e ndre-
kjë gjellën t'ënë si duan urdhurimet
t'atë.

Shejtërò shpirtrat t'anë, rregullò
mendimet t'anë, ndrekjë kjëllimet t'
anë e lirona nga çdò helm, të kekjie
e dhëmbie.

Mbrona me shejtitë ëngjëj t'atë, se
kështù të ruajturë dhe të udhëhekju-
rë nga atà, të bashkuarë te njënia e
Besës, të vemi të përpjekim të pa-
kjasurshmen lëvdi t'ënde, përçë Ti
je bekuar për jetë të jetëvet, amin.

Lipisi, o Zot (3) lëvdi past... Tij
më të nderoshme se Hjeruvimtë e pa
të përkrahur më të lëvdoshme se Se-
rafimtë, që pa fare u ndotur të Lar-
tën Fialë linde, vërteta Mëma t'Zoit
po madhërojëm na.

Krishtlindja - ORA e PARE

mbë embrin e t'in'Zoti
bekona , o At.

I Madh'in'Zot na mëshiroft e na
bekoft e na dëftoft fakjien e 'Tij
e past lipisi për ne ;

o Zoti Krisht,Drita e vërtetë që
ndrit e shejtëron çëdò njeri që vi-
en te jeta,le të shkëlqenjê mbi ne
drita e fakjies s'ate sa na të sho-
hiëm tek ajo dritën të pakjasurshme;
e ndrekjê të jetsurit t'anê te të
ruajturit urdhurimet t'atë,paj të
gjithë Shejtravet t'atë,amin, .

Krishtlindja ORA e TRETË

ORA e TRETË

Bekuar kloft...

Lëvdi Tij... Rregji i kjielliës
çë na përgëzon ...

Trisajon Sejtia isht rregjë-
ria ...

Ejani t'i falemi... v.f. 3 § 4

Ms.66

Perëndia na paçit lipisi e na be-
koft;neve na dëftoft fakjien e 'tij
e na mëshiroft.

Sa të njohiën në dhe dhromin t'ent
e shpëtimin t'ënt te gjithë kombet.

Popujitë të lartësoshin,o Perën-
di,të lartësoshin gjithë popujitë

Krishtlindja - ORA e TRETE

U gëzofshin e bërshin harë kombet , se Ti gjikon popujtë me drejtësi e prin kombet në dhe.

Popujtë Të lartësoshin, o Perëndi, Të lartësoshin gjithë popujtë. Dheu dha pemën e 'tij.

Na bekoft i Madh'in'Zot Perëndia jinë e gjithë anët e dheut i trëmbëshin.

Ms. 86

Themelet e Jerusalemit janë te malet të shejtë. T'in'Zoti i pëlkjën diert e Sionit më shumë se gjithë tendat e Jakobit.

Lëvdì u kanë thënë mbi Tij, o kji - tet i Perëndis !

Krishtlindja - ORA e TRETE

§*****§

Ndër atà që më njohiën do t'kujton Raabin e Babilonën, Filistenjtë e Tirët e populli i Ethiopëvet janë kjetetësë t'atë.

Të Mëmës Sion ka t'thuhet : gjithë njerëzitë len tek ajo e atë e stisi i Larti vet .

In'Zot do t'shkruanjë te të shkruamet e popujvet: këtë len brënda Sionit .

E gjithë ata që jesiën tek ajo janë të gëzuarë.

Ms. 50

Lipisi për mua paçe , o Perëndi, për sa e madhe isht butësia jote; e për sa të shumë janë mëshirët t'atë Ti fshij paligjën t'ime .

Krishtlindja - ORA E TRETE

Po t'êrê më laj së paligjet t'ime
e më dëlir mekatiet s'ime.

Pse u njoh të paligjën t'ime e më-
kata ime po më ë kundra, përherë mua
përpara.

Kundra Tij vetëm u mëkatrova e per-
para fakjies s'ate u bëra të kekji-
en ,sa të daljsh i drejt më fialët
t'ote , e sa të mundësh kur tëjesh
gjikuar.

Se shih se ndë të paligjet u u le-
va edhë ndë mëkatë më zu mëma ji-
me.

Se shih Ti deshe të vërtetën ;Ti
mua më sbëlove të erreshmat e të
fshehurat e urtësis s'ate.

Ti më shtërpik me isopin e u kam
të dëlirem: të më lash e u më se
bora dō t'jem sbardhur.

Krishtlindja - ORA e TRETE

Bën të gjegjem fialë gëzimi e ha-
reje e të përunjëtë eshtrat t'imë
kanë të gëzonen.

Fshihe Ti fakjien t'ënde mëkatë -
shit s'ime e fshiji të paligjet t'-
ime.

Më bën, o Perëndi një zëmërë të dë-
lirë ndë mua e shpirt të drejt më
përtërij brënda mua.

Mos më përzej nga fakjia jote e mos
hilkj meje Shpirtin t'ënt të shejt.

M'u ktheft hareja e shëndeties
s'ate e më mbafshe fort me Shpirt
së larti udhëtar.

Dua të mësonjë udhët t'ote të pa-
ligjëvet e kekjëbëresitë kanë të
priren tek Ti.

Shpëtonë mëkatëshit gjaku, o Perëndi, Pe-
rëndi i shëndetiefs s'ime:gluha ji-

Krishtlindja - ORA e TRETE

me ka të lëvdonjë me gëzim drejtë-
rin t'ënde.

O Zot,më sbill buzët t'ime,e goja
jime ka të rrëfienjë lëvdin t'ënde.

Përsë në dashur kishe flijë,u t'e
kisha dhënë,por Ti nuk kënakje me
olokauste.

Flijë Perëndis isht një shpirt i
grijtur tue dhëmbur;një zëmërë të
prerë edhë të përururë Perëndia nuk
e dishpëlkjen.

Klofshe i mirë,o Perëndi me Sionin
te pëlkjimi jit; e të stisen muret
e Jerusalimit.

Ashtu atëherë do t'marrsh me-hir
flijën e drejtëris,dhuratatë,oloka-
ustet.

Atë herë ka t'bien viçëra therores
s'ate.

Krishtlindja - ORA E TRETE

Lëvdi... nanl ...

Aliluja (3) Lipisi,o Zot (3)

Lëvdi...

U shkrua ahierna ... v. f.12

nanl ...

Mëma e t'in'Zoti,Ti je dhria e
vërtetë që jep pemën e gjellës.
Të lutemi,parkalës , o Mbretëre-
shë,bashkë me Apostojitë e gjithë
Shejtrat sa t'ken lipisi shpirtrat
t'anë .

i d h i o s e l a

Ki ë Perëndia jinë,e s'ka t'jetër
të përkrahet me Atë. Leu nga Virgjë-
ra e vien të jesënjë me njerëzitë.
I Biri i vetëmi i Perëndis ë par

Krishtlindja ORA e TRETE

si një njeri i vdekshëm te një i
mjer grazhd e i Zoti i lëvdës ë
pështiellë me skutina e ylli prin
Magjinjtë sa t'i përmisen e na kë-
dojmë: O Shejta Trini , na shpëtò.

O i Madh'in'Zot,gjegja namin
t'ënt e u trëmba; njoha veprat
t'ote e u çmendA.

Më para se të leheshe,o i Madh'in'
Zot,ushtrit e(kjelliës)Engjëjvet të skoti-
stë e vërrejën këtëmister: Tij që
stolis kjellin me yje të pëlkjen
të lelesh si një fëmijë e të jesh
vënë te grazhdi i shtazavet Ti që
te pallmia e dorës t'ënde mban tërë
dheun.

Me këtë të vepruar t'atë u dëftua
zëmbra e mirë jote,lipisia jote e
madhe . O Krisht ,paue lëvdi !

lëvdi ... nani...

Krishtlindja ORA e TRETE

Thuana,o Josif , si ë që Ti prure
në Vithleëm Vajzën me barrë që ki-
shemarrë nga Shejtoria?

U vëzhgova profetsit,thot Ai, e
kleva njoftuar nga një ëngjëll e
u binda se Marieja ka të lindënjë
Perëndin me një vjershë të pandël-
guashëm. Nga Lindia ka t'vijën Ma-
gjinjtë sa t'i përmisen me dhuretë
të çmuame. O i Madh'in'Zot , që u
mishërove për ne,paqe lëvdi !

prokja; Na leu një Dialë,BIRI,
e kle dhënë neve.

Perandoria e 'Tij mbi
krahët e 'Tij.

nga profetsia e BARUH-ut
(3,36-4,4)

Ki ë Perëndia jinë e s'ka
t'jater të përkrahët me Atë.

Ai sbëloi çëdò udhë të diturisë e ja dha Jakobit shërbëtorit t'tij e Israelit të dashurit t'Tij.

Pas këtireve gjëra u dëftua mbi dhe e jesi me njerëzitë.

Ki isht libri i uirdhurimëvet të t'in'Zoti e Ligja e 'Tij për mot e jetë.

Gjithë atà që e ruajën do t'rrojën, kush e lë mbë nj'anë ka t'vdesënjë.

PRIRU ,Jakob, e pranoje e jits të të shkëlqjerit e dritës s'saj e do t'jesh ndritur.

Mos jip nderin t'ënt njëi t'jetri e çëdo vëjen tij njëi kombi i huaj.

Na jemi të lumë, o Israel, përçë na kle sbëluar që i pëlkjen t'in'Zoti.

nga litra e sh.Palit

GALATIANEVET

3,23-29

Vëllezër, njera që ngë jerdhi Besa, na të gjithë ishëm ruajtur li - dhurë brënda nga Ligja tue pritur Besën që një ditë ki't'na ishë sbëluar. 'Shtù se Ligja u bë pedhago - gi jinë që ki't'na kjillëj te Kri - shti sa na t'ishëm drejtëruar nga Besa.

Kur pra jerdhi Besa ,na ngë klem më përposh kujdestarit. Gjithë jini bij të Perëndisë me besën te Kri - shti Iisù. Gjithë ata që u pagzuat në Krisht , u veshët me Krishtin.

Ngë ka më Judhë a Grek;ngë ka më shërbëtuar a i lir,burr e grua,për - çë gjithë ju jini një gjë te Iisù Krishti. E në ju jini të Krishtit, atëherë ju jini edhe farë të Avra - amit e ,si kle taksur,trazhgimtarë

Vangjeji Lk.2,1-20

v.f.190

Zoti Perëndi isht bekuar,
in'Zot isht bekuar dita n'di-
te.Na vëfshit Ai te dhromi i
mirë,Perëndia i shëndetës t'
kënë.Perëndia jinë ë një Perën-
di që shpëton.

T r i s a j o n Se jotia isht
nregjëria...

kondakjion: Virgjëresha sot në sh-
pellë

lipisl,o Zot, (40)

O Zoti Krisht Perëndi... f. 20

lipisl,o Zot (3) Lëvdi past...
Tij më të nderoshme f. 21.

mbë embrin e t'in'Zoti
bekona , o At.

I madh'in'Zot na mëshiroft e na
bekoft e na dëftoft fakjien e 'Tij
e paçit lipisl për ne .

O Zoti Perëndi,At i gjithëmëndëm,
Zoti Iisù Krisht,e Shpirti i Shejt,
një Hjyni,një fukji,paçelipisl për
mua i mëkatruam e te gjykji që ka t'
mbash shpëtomë mua,i pavëjëfshëm
shërbëtuat t'ënt,se Ti je i bekuam
për jetë të jetëvet, a m i n .

ORA e GJASHTETE

Bekuar kloft ...

Lëvdi Tij... Rregji i kjelellës...

Trisajon... Se jotia isht rregjê-
ria ...

Ejani t'i falemi a.. v.f. 3 & 4

Ms. 71

O i Madh'in'Zot, jip gjëkimin t'ënt
rregjit e drejtësin t'ënde të birit
e rregjit.

Sa atà të gjëkojën popullin t'ënt
me të drejt e të vapkjité t'atë me
urtësi.

MAlet le t'presiën mirë pakjien e
popullit ,kodrat drejtësin.

Gjikëtar i drejt do t'jet për të
vapëkjité e popullit e ka t'shpëtonjë

Krishtlindja ORA e GJASHTETE

Te bijët e të mjerëvet e atà që i
shpifiën ka t'i përunjë.

E in'Zot ka t'mbetet njer që ë
dielli e hënëza, brez pas brezi.

Do t'sdripet si shiu mbi leshët
e si ujët që pikë pikë potis dhe-
un.

Te ditët e 'tija do t'lulëzonjë
drejtësia e pakjëtím i plot:njera
që ngë shuhet hënëza.

Edhë ka t'zotëronjë nga një de-
jt njera te t'jetri e nga lumi nje-
ra te gjithë anët e dheut.

Etiopët do t'i përmisen përpara
e armikjët e 'tij ka t'lipijën plë-
htë .

Rregjêrat e Tarsis e ishujit do
t'faliën dhuretí bashkë me rregjê-
rat e Sabês dhe të Arabis.

Krishtlindja - ORA e GJASHTETE

Gjithë rregjêrat e dheut ka t'i përmisen e gjithë popujtë ka t'E shërbejën.

Se ka t'lironjë të vapëkun nga i pushtetshmi që e shtip, të mjerin që ë pa ndihmë.

Ka t'ket lipisi për të vapëkun e për të mjerin; ka t'i shpëtonjë gjellat e të vapkjëvet.

Nga kamata do t'lironjë shpirt-rat e 'tire e nga e shtrëmbëra, e i nderuar do t'jet embri i 'tij nga atà.

E ka t'rronjë e ka t'i japiën atij nga ari i Aravis e ka të parkalesiën kurdoherë për atà; gjithë ditën ka t' e bekojën.

E ka t'jet buria e drithit njer te majet e malëvet e kallinjte më

Krishtlindja - ORA e GJASHTETE

të lertë se atà të Libanit e kjetetëzit do t'lulëzojën si bari i dheut.

Embri i 'tij kloft bekuar për jetë e kjëndroft njer që ë diell;

E gjithë farët e jetës do t'jen bekuAR e gjithë kombet ka t'e lumërojën.

Bekuar kloft Perëndia i Israelit, i Vëtimi që bën famasë .

E bekuar embri i lëvdës s'tij në jetë e për jetë të jetëvet.

E ka t'mbushet me lëvdën e 'tij jeta e gjithë. Kloft , kloft !

Ms.131

Kujtò, o i Mësh'in'Zot, Davidhin e gjithë butësin e 'tij.

Kujtò se ai buri be t'in'Zoti; ai i taksi Perëndis s'Jakobit.

Krishtlindja ORA e GJASHTËTË

Në u hinj te tenda ku do t'jes; në u ngjipem te shtrati ku u do t'prëhem;

Në u jap gjum syvet t'imë e të dërmitur kjepallavet e mia e prëhie vetullavet t'ime;

Njer çë ngë gjenj vend t'in'Zoti, një tendë Perëndis s'Jakobit, (klofsha u munduar !

Shi' na gjegjëm se ndodhet në Efrahtâ; e gjetëm në fushat e pyllit.

Ka t'vemi te tendat e 'tij, ka t'i falemi përmist te vendi ku mbeten këmbët e 'tij.

Ngreu, o i Madh'in'Zot, nga pushimi i jit; Ti e arka e shejtërimitt'ënt.

Priftrat do t'veshiëndrejtësin e shejtrat t'atë do t'gëzonen.

Krishtlindja - ORA e GJASHTËTË

Paj t'Davidhit shërbëtorit t'ënt, mos të prierësh fakjien të lyejturit t'ënt.

Bëri be in'Zot Davidhit mbi të vërtetën e ngë do t'e mohonjë; ka të vë te throni i jit një nga pema e gjirit t'ënt.

Në bijët t'atë ruajën dhiatën t'ime e këta deshmime çë U ka t'i dëftonj atireve;

Edhë bijët e 'tire për jetë ka të ujen mbi thronin t'ënt.

Se sglodhi in'Zot Sionin ; i pëlkjeu Atij të rrij tek ajo.

Ki vendi i prëhies t'ime për jetë të jetëvet:këtù U dua t'jes, se ajo më pëlkjeu.

Me bekime do t'bekonj derën e 'saj; me bukë dua t'tsinj të vapkjitë e 'saj.

Krishtlindja - ORA e GJASHTETE

\$\$\$\$\$\$\$\$\$\$\$\$*****

Me shëndetë do t'vesh'priftrat e
'saj e shejtrat e 'saj do t'gëzonen
me harë.

Atjè do t'lartësonj fukjin Davidit,[?]
përgatita flakën të Lyejturit t'im.

Armikjët e 'tij do t'i vesh me tu-
rp, po mbi atë do t'shkëlkjenjë shaj-
tëria jime.

Mss. 90

Ai çë prëhet nën pështrimin e të
Lartit, jet te hjeja e Perëndis së
kjiellit.

E do t'i thet t'in'Zoti: Ti ndih-
ma jime, Ti pështrimi jim, o Perëndia
jim, e ka t'shpresonjë tek Ai .

Përçë. Ai ka t't'lironjë nga rriet-
tat e gjuanjësëvet e nga fialë fte-
sie.

Krishtlindja - ORA e GJASHTETE

Krahët e 'Tij ka të t'hjesojën e
përposh fletëvet t'Tij do të shpre-
sosh.

E vërteta e 'tij ka të t'rrethonjë
si mburonjë; ngë ka të trëbesh as per-
dre natën, as për shigjeta çë flutu-
rojën ditën.

As për murtajën çë rrieth natën as
për sulme të diallit në mes të ditës.

Ka t'bien mijëra te ana jote, dhietë mijëra
tek e drejta jote; po tij ngë ka të
kjaset e liga.

Sa Ti vërren me syt t'atë, ka të
shohësh mundimin e të mëkatruamëvet.

Përçë Ti, o i Madh'in'Zot , je shpre-
sa jime !

More për mbronjës të Lartin: atë
herë ngë do të t'streksënjë gjë
të kekjë; as lëngatë ka t'kjaset ten-

Krishtlindja ORA e GJASHTETE

dës t'ënde.

Përçë do t'i urdhuronjë ëngjëjvet
të 'tij sa të t'ruajën te dhromet
t'atë.

E se kanë të t'ngrejën mbi duart,
sa mos të ksesh kurr mbi gur këmbën
t'ënde.

Sa të jetsësh mbi aspide e vasili-
skjë e do t'shkelsh luanë e drango-
një.

Përçë shpresoi tek U e U dua t'e
lironjë;dua t'e ndih senjohu ëmbrin
t'im.

Kur ai të më thërresënjë,dua t'e
gjegjem;me atë do t'jem ndë helm;
dua t'e shpëtonjë e t'e lartësonjë.

Ka t'e bënj të rronjë ditë të gla-
tae t'i dëftonjë shpëtimin t'im.

Krishtlindja - ORA e GJASHTETE

lëvdi past ... Aliluja... (3)

Lipisi,o Zot,... (3) lëvdi past...

U shkrua ahierna ... f. 12

nani e për gjithëmonë

POSA ngë kemi gudsim për të shumë-
tat mëkatë t'ona,vuru për në mes Ti
tek Ai që leu ngah Ti,o Virgjërë
Mëmë të t'in'Zoti. Shumë mëndë par-
kalesia e njëi mëmie sa të sbutson-
një të Zotin. Mos përbuz lutiet e
të mëkatruamëvet,o gjith'e ponisësh-
me,pse Kush me-hir deshi të duroj
te kurmi i 'tij për ne isht lipisi-
ar e mëndë të shpëtonjë.

Krishtlindja ORA e GJASHTBTE

i d h i o e l a

Ejani, o të besmë, ngrëhemi e të mbushurë me shpirt hjynor le të mejtojëm mbi të jardhurit në mes neve haptas në Vithleëm të Perëndis. Tue pastruar mendien le t'i faliëm t'in'Zoti në gjellën t'ë-në virtutë në vend të mirrës tue përgatitur kështu të hijturit t'a-në tek e kremtia e Krishtlindies, tue mbëjedhur vistare te shpirti jinë e tue uluritur: Lëvdi te më i larti kjiell Perëndis në Trini të 'Tij të shejte, pëlkjimi i të çilit na kle sbëluar neve e çë si Mik i njerëzvet, liroi Adhamin nga e motçmia nëmë.

O i Mad'in'Zot, gjegja...f.30

Krishtlindja - ORA e GJASHTETE

Gjekjë, o kjiell; mirr 'veshë , o dhe. U shkundëshin themelet, u dridhëshin nënshtresat e dheut , pse ß Perëndia e Kriuesi u mveshë me mishë. Atë çë me krahë të fortë stisi jetën e shohiëm nani në gji t'Asaj çë Ai vet gjeshi.

Sa të humbta pasuria, dieja, njohia e Perëndis !

Sa pa të vëzhguarshmë gjikimet , sa pa të hetuarshmë udhët e 'Tij!

lëvdi ... nani ...

Ejani, o popuj Krishtprurësë të vegojëm këtë famasmë çë skotis çëdò mendie .

Sot vien në Vithleëm një vajzë me barrë sa t'lindënjë t'n'Zonë. Koret e Engjëjvet i rriedhiën përpara. E. tue par këtë Josifi, dhëndërri, thërret: çë mister i huaj ë tek

Krishtlindja - ORA e GJASHTETE

Ti, o Virgjërë ? E si ka t'lindësh
Ti, mushkjerrë pa dsigua ?

prokjim. Më para se agimi U të pata
nga gjiri jim. Bëri/pe in'Zot
e ngë do t'pendonet.

Tha Zoti t'im Zoti: uju
tek e drejta jime njera çë
U vë armikjët t'atë nën kë-
vet t'ote.

nga profetsia e Isals 7,10

E shtoi të flisëj Ahazit in'Zot
e i tha: lip për tij një shenk nga
Zoti Perëndia jit; nga të humbëtitë
e prej së larti.

E Ahaz tha: ngë dua t'e lip e ngë
dua të nga t'ën 'Zonë .

E tha Isaia: atëherë dëgjô, o shpi
e Davidhit, 'omse ë pak për ju të

Krishtlindja - ORA e GJASHTETE

lodhëni durimin e njerëzëvet ?

E nanë do të lodhëni atë të Perën-
dis ? Prandaj in'Zot vet ju jep një
shenk: Shi' Virgjëra ka t'zënjë në
gji e ka t'i lehet një Bir e ka t'i
vën embrin e 'tij Emanuil, çë kë-
thier vien më rar **Perëndia me**
ne. Ai ka t'hanjë gjalp e mjaftë
njera çë të njohënjë si ka t'jikënjë
të ligën e të sgledhënjë të mirën.

Përçë më para se Diali të njohënjë
të mirën e të ligën, ngë arrën e li-
ga të sgledhënjë të mirën.

E më tha in 'Zot: mirrë një libër i
mathë e shkruaj me pendë njeriu: bëj
me rrëmbim ndarie plaçkash-vëlën-e
për deshmëtarë kirrëmë burra besnikë
Urnë priftin e Zaharin të birin e
Barahjis.

E vanë te Profetesha e ajo zuri në
gji e i lindi një dialë.

E më tha in'Zot: njize , plaçkò e
ndaj me rrëmbim, pse më para se diali

Krishtlindja ORA e GJASHTETE

të die të thërresënjë të jatin
e të jëmën,ka t'marrënjë fukjin
e Damaskut e plaçkat e Samaris për-
para rregjit i AssiriaNëvet. In'Zot
ê me ne : t' e dini ju , o kombe e
të përuij. Të gjegjij të gjithë nje-
ra tekû sos dheu. Ju të pushtetshmë,
të përuij.Pse në mirrëni prapë fu-
kjl ,prapë do t'jini përuijur. E në
kini ndo mendim,in'Zot ju e prish.

E në do t'thoni ndo fialë,ngë kjën-
dron ndër jush,pse me ne isht in'Zot.

nga litra e Shën Palit

Ebrenjevet

1,10-2,3 .

Ti,o Perëndi,në të zënit fill sti-
se jetën e vepra të duarëvet t'ote
janë kjellliat;atà ka t'humben ,po Ti ka t'
kjëndrosh;gjithë si pethka ka t'vjetronen
e si të veshura ka t'i përntiëllësh atà

Krishtlindja - ORA e GJASHTETE

e ka të ndërronen,po Ti je gjithë-
monë Ai e viëtçët t'atë ngë ka t'
shkojën. E kuj te Engjëjitë i ka
thënë kurr : "uju tek e drejta ji-
me njera çë të vë armikjët t'atë
përposh këmbëvet t'ote ? Atà ngë
janë të gjithë shpirtra punëtorë
çë në shërbesë dërgonen për atà çë
kanë të trashgojën pajën e shpëti-
mit Prandai i duhet se ne të vum
më shumë kujdes mbi atò çë kemi gje-
gjur,mos ndo herë t'i sbleriëm.

Përsë në fiala e thënë nga ëngjë-
jitë duall e vërtetë e nganjë pau-
dhëri dhe nganjë pagjegje pati rro-
gën çë ngisëj,të drejtë,,si ka t'e shkaptò-
jëm na në ngë kemi kujdes për shën-
detë kakjë të madhe ?

E çila zu t'ishë ligjëruar nga in'Zot e
pra na kle vërtetuar nga atà çë e gjegjën.

Krishtlindja - ORA e GJASHTETE

Vangjeji Mt. 2,1-13 v.f.193

Le mëshirët t'ote të paravijën
shpejt mbi ne,pse u vapëkësuan
fort;ndihëna , o Perëndi,Shpëtuesi
jinë,paj të lëvdës e embrit
t'ënt. O Zot ijëna afër te mëkatët
t'ona paj t'ëmbrit t'ënt.

T r i s a j o n Se jotia isht rregjêria

kondakjion : Virgjêresha sot ... f.20

Lipisi,o Zot (40)

O Zoti Krisht Perëndi ... f. 20

Lipisi,o Zot (3) Lëvdi past...

Tij më të ndersoshme... 21

mbë ëmbrin e t'in'Zoti bekona , o
At.

I Madh'in'Zot na mëshiroft e na
bekoft e na dëftoft fakjien e 'Tij

Krishtlindja - ORA e GJASHTETE

e paçit lipisi për ne.

O Perëndi e Zoti i fukjivet E Kri-
ues i gjithë kriesës,çë paj të ma-
dhes lipisi s'ate të papërkrahursh-
me dërgove t'ët Bir të vetëmin,Zo-
tin t'ënë Iisu' Krishtin për shpët-
timin e farës t'ënë e paj të çmuam-
mes krikjie t'Tij shkjorre dorësh-
krimin e dënimit të mëkatëvet t'ona
e munde mbi zotërit e fukjlt e të
errëtit,Ti,o Zot,njeridashës,prit
mirë këtë lutie falnderimi dhe të
lipuri ngak na të mëkatruamë.

Ruana nga çëdo mëkatë e ërrët e çë
prish e nga gjithë ata armikjë të
parshmë dhe të paparshmë çë kërk-
jën të na bëjnë të kekjë.

Shpo mishët t'anëme gozhdat e trëm-
bësirës t'ënde e mos le zëmbrat t'
ona të lëhen fialëve a mendime të
të kekjies,po plagos shpirtrat t'a-
në meq mallin t'ënt,sa na, tue mbaj-

Krishtlindja - ORA e GJASHTETE

tue syt tek Ti kurdoherë e
të udhëhekjurë nga Drita që
vien ngah Ti ,Dritë e pakja-
surshme dhe e pasosme,të Të
japiëm pa pushim lëvdë e
falnderim Tij të pazënit AT
me Birin t'ënt të vetëmin-ler
bashkë me gjithëshejtin e i
mirë e gjellëdhënës Shpirt,
nani e kurdoherë e për jetë
të jetëvet,amin.

ORA e NENDETE

Bekuar kloft ...

Lëvdë Tij... Rregji i kjiel-
liës ...

Trisajon Sejotia isht rregjéria

Ejani t'i falemi... v.f. 3&4

Ms.109

Tha Zoti t'im Zoti:uju tek e
drejta jime njera që U vë armikjët
t'atë nën këmbëvet t'ote.

In'Zot ka të dërgonjë shkopin e
fukjls nga Sioni;zotërë ti në mes
s'armikjëvet t'atë.

Krishtlindja - ORA e NENDETE

Ti do t'urdhurosh te dita e push-
tetit t'ent, ndër të shkëlqier-
it e Shejtravet t'atë.

Më para se agimi U të pata nga gji-
ri jim; bëri be in'Zot e ngë do t'
pendonet: Ti je prift për gjithëmo-
në nga rradha e Melkjisedekut.

In'Zot tek e drejta jote, te dita
e mbëris s'tij, drëmoi rregjërat .

Ai ka t'gjikonjë kombet; ka t'mbu-
shënjë dheun me kurme të vdekurish,
ka t'shtipënjë mbi dheun krerat e
shumë vetëve.

Nëpër dhrom do t'pie në përrua;
prandaj do t'ngrënjë kriet.

Ms.110

Dua t't'lartësonj, o i Madh'in'Zot

Krishtlindja - ORA e NENDETE

me gjithë zëmbren t'ime, në këshill
e mbëledhie të të drejtëvet.

Të mëdha janë veprat t'ote, o i Ma-
dh'in'Zot, e të kërkuara nga ata
që ja ka ënda tek atò.

Puna e 'tij isht lëvdërim e madhë-
ri; e drejtësia e 'Tij mbetet në
jetë të jetëvet.

La një kujtim të çudhivet t'tij:
lipisiar e zëmbregjerë. Ai i ush-
kjen ata ç'i trëmben.

Ai do t'kujtonjë gjithëmonë dhia-
tën e 'tij; pushtetin e veprave
t'tij ja dëftoi popullit e 'tij tue
i dhënë trazhgimin e kombëvet. Ve-
prat e duarëvet t'tij janë vërtetie
e gjikim .

Krishtlindja - ORA e NENDETE

Urdhurimet e 'Tij janë të patundhmë,
të vërtetuarë jetë pas jetie, të bërë në
të vërtetë e të drejtë.

Ai dërgoi shpërblimin popullit
e 'tij; për gjithë jetët urdhuroi
dhiatën e 'tij.

I shejt e i dreruashëm embri i
'tij . Të zënit fill e diejës :
trëmbësira e t'in' Zoti .

Ndëlgim të mirë kanë atà që e ru-
ajën. Lëvdërimi i 'tij kjëndron
për gjithëmonë.

Ms.85

Prir veshin t'ënt, o Zot, e gjegjë-
mé se i vapëk e i mjerë u jam.

Ruajëmë shpirtin se jam i drejt.
Shpëtò, o Perëndia jim, shërbëtorin
t'ënt se shpreson tek Ti.

Krishtlindja - ORA e NENDETE

Kijëmë lipisl, o i Madh'in'Zot,
se gjithë ditën të kam uluritur;
gëzò shpirtin e shërbëtorit t'
ënt , se tek Ti u ngrëjta shpirtin .

Se Ti je i mirë e gati të ndëjësh
e plot me lipisl me atà që të thë-
rrësiën.

Gjekj, o Zot, parkalesin t'ime,
vër 're zërit e luties s'ime .

Te dita e helmit Tij të thër-
rita e më gjegje .

Ndër perëndit mosnjëri të glet;
mosnjëri bën veprat t'ote .

Gjithë koimbet, akjë sa Ti bëre,
do t'vijën e t't'përmisen, o i Maë
dh'in'Zot , e do t't'lëvdojën.

Pse Ti je i mathë e bën famasmë;
Ti i vetëmi Perëndi.

Krishtlindja - ORA e NENDETE

Udhëheqjëmë Ti, o i Madh'in'Zot te dhromi jit e u do t'jets te vërtetia jote.

U dua të t'largësonjë ,o Zot Perëndia jim, me gjithë zëmbërën t'ime edo të lëvdonj ëmbrin t'ent për jetë.

Pse lipisia jote isht e madhe mbi mua: më lirove shpirtin t'im nga pisa e humbëtë.

O Perëndi, të paligjëti u sulën kundra meje e mbëledhie të fortësh më kërkuan gjellën e ngë deshën të kujtonëshën nga prania jote.

E Ti, o Zot Perëndia jim, i dhëmbës shëm; zëmbërnjomë, i duruashëm, lipislar e i vërtet; vërrejëmë e kijmë lipisi.

Jip fukjin t'ende shërbëtorit t'ent e shpëtò të birin e shërbëtores t'ende.

Krishtlindja - ORA e NENDETE

Jipëmë mua një shenk i mirë sa të ndëlgojë atà që më kanë mbëri e u ngukjëshin, për që Ti, o i Madh'in'Zot, më ndihe e më ngushëllove .

lëvdi past ... aliluja... (3)
lipisi, o Zot (3) lëvdi past...

t r o p a r i i:

U_shkrua ahierna ... f. 12

nani e gjithëmonë

O Ti që për ne leve nga Virgjëra e durove krikjien, o i Mirëth, Ti tue shkelur mortien me vdekjien, na dëftove ngjallien si Perëndi: mos le mbë nj'anë ata që me dorën t'ende gjeshe. Dëftò, o Lipislar, dashmirësin t'ende, prit mirë Mëmën t'ende që Të leu, se ajo isht e të parkales për ne e shpëtò, o Shelbuesi jinë, popullin të dëshpëruam.

i d h i o m e l a

U çudhit Erodhi kur pa lutësin e
Mëgjinjëvet e mundur nga mbëria zu
të masëj kjeroin kur leu Diali.

Mëmat sbuarën bijët e 'tire: në
moshë të pa bërë klen korrur me hi-
dhërim; u tertën sisët, u thajtën
burimet e klëmshtit. E kekjia kle
e madhe! Andai na me lutësi, o të
besmë mbëjidhemi t'i përmisemi Lin-
dies e Krishtit.

Perëndia ka vinjë nga Thema-
ni e ... f. 14

O Virgjërë, kur pe Josifin të
vej Vithleëm i mërzhitur, more e i
the: përçë si më sheh me barrë
trazone, tërbone? Përçë ngë njeh **KË**
KREJT misterin të tmerrshëm që
bënet tek U? Përzë çëdò dre e men-
dò këtë famasmë : përçë Perëndia ,

paj t'lipisis që ndien për ne, sdrì-
pet në dhe, te gjiri jim, e merr mi-
shët. Ti ka t'e shohësh kur t'lehet
si Atij i pëlkjeu, e i mbushur me ha-
rë do t'i përmisesh si Kriuesi jìt.
Atë që Engjëjitë këndojën pa pushim
e lëvdojën bashkë me Atin e me Shpir-
tin Shejt .

lëvdi ... nani ...

Bot lehet nga Virgjëra Ai
që mban gjithë kriesën në pë-
lëmbë të dorës.

Me skutina kle pështiëllë si
njeri Ai që në të klënit t'Tij
isht i padukëshëm.

Perëndia isht ngulu te një grazhd
Ai që kjëndresën i dha kjëlliavet
që moti në të zënit fill.

Nga sisë ushkjenet me klëmshtë ,
Ai që në shkretirë ujisi popullin
me mannën .

Krishtlindja - ORA e NENDETE

Magjnjtâ thërret Dhëndërrin i Klishtës .

Dhuretët e këtireve merr i Biri i Virgjëreshës .

NA i falemi të nderit t'atë, o Krisht .

Dëftona të dukurit t'atë të hjynushëm .

prokjm. ms.86 MEMA SION do t'ë thërrasnjë njeriu e një NJERI' leu tek ajo.

Themelet e 'tij te malet të shejtë.

nga profetsia e Isais 9,6-7

Na leu Diali , Biri , e na kle dhënë neve . Perandoria e 'tij isht mbi krahët e 'tij. E embri

Krishtlindja ORA e NENDETE

i 'tij ka të thërritet : Engjelli i këshillit t'mathë, Këshilltar i famasëshëm , Perëndi i fort, i push-tetshëm , krietar i pakjies, Ati i jetës s'ardhëshme. E MADHE PERANDORIA e 'tij e të pakjies s 'tij s'ka kufi mbi thronin e Davidhit e mbi mbretërin e 'tij sa t'ë ndrekjnjë e t'i japënjë kjëndresë, çë nani e për jetë .

Zeli i Zotit t'ushtrivet ka të bënjë këtë.

nga litra e sh.Palit

EBRENJEVET

2,11-18

Vëllezër, Ai çë shejtëron e të shejtëruamitë janë gjithë nga një.

Prandaj ngë ka turp t'i thërrasnjë vëllezër tue thënë: Dua të lajmëronj embrin t'ënt vëllezërvet t'i

më . Do t't'lëvdonj në mes s'Mbëledhies" E përsëri: "U do t'kem besim tek Ai" E prapë:"Këtù jam u e bijët që in'Zot më dha.

Posa andai bijët kanë pjesë te gja-ku e te mishët,gjithashtù edhe Ai ka pjesë me atà. Sa paj të vdekjes të prishëj atë që kishë zotërin e morties v.m.th. diallin e të liroj gjithë atà që për dre të vdekjes ishën si në robëri. Vërteta Ai ngë vien të ndihënjë Engjëjitë,po fa:-rën e Abramit.

Shi' përçë i ngisëj t'i glisëj te gjithkujsh vëllezërvet: sa të bënej te shërbesa e t'in'Zoti,një Krie - prift lipisiar e besnik,i zot të shpaguej mëkatët e popullit.

Pse kështù tue duruar Ai ngarie e vuajtje mënd't'ndihëj atà që janë ngar.

Vangjeji Mt. 2,13-23

v.f. 195

Paj t'embrit t'ënt të shejt mos na le për gjithëmonë,mos prish dhia - tën t'ënde.

Paj t'Abramit i dashur ngah Ti,t'Isakut shërbëtori jit e Israelit i Shejti jit,mos largò ngah na lipisit t'ote.

Trisajon Se jotia isht rregjëria...

KONDAKJION/ Virgjëresha sot... f.20

LIPISI,o Zot (40) O Zoti Krisht...f.20

LIPISI,o Zot (3) lëvdi past...Tij më të nderoshme se Hjeruvimtë ... f. 21

më embrin e t'in'Zoti,bekona,o Zot.

I mach'in'Zot na mëshiroft e na bekoft e

Krishtlindja ORA e NENDETE

e na dëftoft fakjien e 'Tij e
paçit lipisi për ne .

O i Zot e Zot Iisù Krisht,Perëndia
jinë, që na u ke dëftuarzëmernjomë
për mëkatët t'ona e na ke prur njera
te kjo herë ,e çila isht ora kur
vjërrë te krikjia i sbille kusarit
të mirë Parraisin e me vdekjien t'
ënde munde mortien,kij lipisi edhë
për ne të mëkatruamë e të pavëjës-
shmë shërbëtorë t'atë.

Kemi mëkatruar e kemi shtipur Li-
gjën t'ënde e ngë jemi të mirë të
ngrëjëm syt e të vërrejëm lartësin
e kjielliës,përçë lam dhromin e
drejtësis e vam prapa deshirevet e
zëbravet t'ona.Po nanë i priremi
mirësis t'ënde të papërkrahurshme.

Ndëjena ,përse e madhe isht lipi-
sia jote e shpëtona paj t'embrit
t'ënt të shejt? përçë në kotësira

Krishtlindja ORA E NENDETE

u kanë josur ditët t'ona.
Hilkjëna nga dora e armikut e ndë-
jena mëkatët e jip mortë mendimevet
mishi t'imë; sa na,tue lënë njeriun
i vietër të mveshiëm të riun e të
rrojëm për Tij,i zoti jinë e mbroj-
tës.

Se kështù na , tue jetsur si duan
urdhurimet t'atë,të arrëjëm te pu-
shimi të pasosëm tekù isht ndenja
e gjithë atireve që janë në gëzim.

Pse Ti je pë 'ftet e vërteta harë
e gëzim t'atireve që të duan mirë,
o Krisht Perëndia jinë e na të ja-
piëm lëvdil TIJ me të pazënin At
t'ënt e gjithëshejtin e i mirë Shpirt
t'ënt,nanë e kurdherë për jetë të jetëvet,
a m i n .

te dita më para se

THEOFANIA

(Ujë të pagzuan)

ORA e PARE

Bekuar kloft ...

Lëvdë Tij... Rregji i kjiel-
liës ...

Trisajon Se jotia isht rre-
gjëria ...

Ejani t'i falemi ... v.f. 3 & 4

Ms. 5 v. F.5

I
heofania +Ujë të pagzuan-ORA e 1.

Ms. 22

Perëndia isht delmeri jim e mua
ngë do t'më lipset gjë.

Al më vuri të rri në vend bari të
njomë, të kullos ; më kjelli mbë
ujëra dhrosie , të prëhem.

Më ndrekji shpirtin në vend të kje-
tëm, të ngjallem; më solli për në
dhromëshit të drejtë, mos sbirem, paj
t'embrit t'tij.

Në u shkofsha edhë në gropësirat
të errëta nën hjes të vdekjes; ngë
do t'kem dre për ndonjë të kekjie,
se Ti je bashkë me mua .

Purteka jote e shkopi jit:këtà mua
më bien gëzim.

Theofania - ORA e PARE (Ujët të pagzuan)

Ti më shtrove përpara një triesë të plotë nën sivet e atireve që më shtrëngojnë: më liejte me vaj ërësh kriet t'imë: sa i ëmbël ai kjelkjë që më den.

Të mirat e huret t'atë më jardhën shin bashkë gjithë ditët e gjellës s'ime.

E U ka t'jes te shpia e Perëndis ditë të glata.

Ms. 26

In'Zot drita jime, shpëtimi jim. Kuj ka t'i trëmbem? In'Zot mbronjë si i gjellës s'ime; kush mëndë të më dreronjë?

Si m'u kjasën të kekjitë të më ha-jën mishërat t'imë, këta armikjë që

Theofania (Ujët t'pagzuan) ORA e PARE

më ndjikiën u dobësuan e ran.

Edhë të më shtronet përpara një ushtri, zëmbra jime ngë do t'trëmbet.

Edhë të më bëjën luftë, edhë ah-erna do t'shpresonj.

Një gjë i lipa t'in'Zoti e këtë do t'kërkonj: le të kjëndronjë u te shpia e t'in'Zoti gjithë ditët e gjellës s'ime.

Të shikonjë bukurin e t'in'Zoti, të shoh faltoren shejte e 'tij.

Se më fshehu te tenda e 'tij' te dita e helmevet t'imë; më pështroi te vendi më i fshehur të tendës s' Tij.

Mbi shkëmbin më lartësoi e nani ngrëjti kriet t'im mbi armikjët e mi.

Theofania ORA E PARE

Vajta rreth rreth therores e bëra flijë
te tenda e 'tij,një flijë lëvdimi
e haidhie.Kështù do t'këndonj e
t'nderonjë t'ënE'Zonë.

Gjekj,o i Madh'in'Zot , zërin t'im
të thërrita:kijmë lipisi e digjomë.

Zëmbra jime të tha: u kërkonj t'ën
Zonë; syt t'imë kërkojën Tij.ËJ,o
i Madh'in'Zot, do t'kërkonj gjithë-
monë fakjien t'ënde.

Ti mos prir fakjien t'ënde prej
mejëe mos u largò nga shërbëtori jit
membërl.

Klofshe ndihma jime ; mos më për-
buz ,mos më le,o Perëndi Shpëtuesi
jim.

Më la tata jim , më la mëma,po ine
Zot më priti mirë.

O i Madh'in'Zot,mësomë Ligjën e

Theofania ORA e PARE

udhës t'ënde e udhëhekjëmë te dhro-
mi i drejt,paj t'armikjëvet t'imë.

Mos më le te duart e atireve që më
ndjekien,pse u ngrëjtën disa desh -
mëtarë të rremë kundra meje dhe e
kekjia tha të rremen për 'të.

U kam besim të shoh të mirat e
t'in'Zoti në dhe të të gjallëvet.

Shpresò tek in'Zot e mfortësò zë-
mërën t'ënde e shpresò tek in'Zot.

lëvdi past ... ALILUJA (3) lipisi,
o Zot (3) lëvdi past...

U pruar një herë lumi i Jor-
dhanit me likurën e Eliseut
kur u ngjip Ilia e u ndajtën ujë-
rat atei e këtei e udha e ujit u

Theofania ORA e PARE

bë atij e terme si fitirë vërteta
e Pagëzimit pr'anë të çilit na sh-
kojëm mb'at'anë lumit e gjellës.

krishti u dëftua në Jordhan të shej-
tëroj ujërat .

nanì ...

Si ka t't'thresiëm ... f. 13.

i d h i o m e l a

Sot i ujëravet shejtëronet
vehtia e Jordhani çahet e va-
lat e 'tij ngë rriedhiën, po
mbahen si shohiën lar të Zotin.
për prokjiemenin v.77

Ti rrekjë, o Zoti Krisht, jerdhe
te lumi si njeri e Ti, o i Mirëth, a-
nangase të marrësh nga duart e Jan
Prodhromit pagzimin shërbëtori paj
të mëkatëvet t'ona, o njeridashës.

Theofania ORA E PARE

Mbi zërin t'Atij që ulurij në sh-
kretirë: ndërtoni udhën e t'in'Zoti,
Ti jerdhe , o Zot, në fitirë shërbë-
tori tue lipur pagzimin, Ti që ngë
njohe mëkatë. Ujërat Të pan e u
trëmbën. Kle marrë nga dreja edhe
Prodhromi e uluriti tue thënë: si

mëndë hërnari të ndritënjë Dritën ?

Si mëndë shërbëtori të vënjë dorën
mbi të zotin ? Shejtërò mua edhe
ujërat, o Shpëtues, Ti që ndsler më-
katën e jetës .

Prokjiemeni pas të parit idhiomel:

Prandaj ka t't'kujtonj Tij nga
viset e Jordhanit dhe e Hermonit,
nga mali i vogël. (ms.41,7)

Prokjiemeni i profetsis:

Zëri i t'in'Zoti ë mbi ujërat; u
ndle bumbullima e Perëndis s'lëvdis.

Theofania ORA E PARE

In'Zot mbi shumë ujëra.(ms.28,3)

-Të dua mirë,o Perëndi.In'Zot fu -
kja jime,kjëndresa jime,pështrimi
i jim.(ms.17)

nga profetsia e Isais

35,1-10

Kështu foli in'Zot: gëzou,o
shkretirë e thatë etiet,bëj
harë e lulëzou si lil.

E vërteta shkretirat e Jor-
dhanit ka t'lulëzojën e t'mbu-
shen me bima e do t'gëzohen.

Lëvdia e Libanit do t'jet e
'tiria si nderia e Karmelit.

E populli jim ka t'shohënjë
lëvdin e t'in'Zoti,lartësin
e Perëndis. Mfortësonij o du-
ar të dobëta , o glunjë të njomë.

Parkalesni e thoniatireve që ka-
në zëmbren e vogël: fukjl,mos trëm-
bij.Shi' Perëndia jinë isht e vien

theofania ORA E PARE

të bënë ligjë,t'ju shpërblenjë.
Al isht e vien e ka t'ju shpëtonjë.
Ahierna syt e të verbërvet ka të
sbillen , veshët e të shurdhurëvet
ka t'gjegjen. Ahierna i shklepuri
ka t'këtsënjë si drer e gluha e të
pagoit ka t'këndonjë.

Përçë në shkretirë ujërat ka të
plasiën e në dhe të that etie do të
rriedhiën lumet. Bota pa ujë ka t'
mbëlonet me lutse ,dheu i that etie
ka t'shndërronet në një krua uji/
gëzim për zogat,banesë për sirenët,
e kallme e bërraka.

Eka t'lehet atjë një udhë e pastrë
e ka t'jet thritur udha e shejtëris.
Ngë ka t'i shkonjë njeri që ngë
isht i pastër ,as një dhrom do t'jet
për të ndëtitë.

Të sbierritë do t'shkojën andei e
ngë ka t'gabojën më.

E atjë ngë ka t'ndodhen luan as t'

jerë bishëra të egëra.

Atjë do t'shkojnë të shpërblieritë
e që u mbëjodhën bashkë për t'ën'Zo-
në e ka t'puren e ven në Sion me
harë e gëzim.

Këndime gazmorë do t'përsielliën
gjellën e 'tire pa dhëmbie, pa lip,
pa psherëtim.

nga TË BËMAT e Apostojvet

(13,25-32)

Si ish'e mbaroj Jani urdhuratën e
'tij,vej tue thënë: pë' kë më mua-
rët ? Jo , ngë jam u ai që prini.

Po isht e vien një pas meje të të
qilit u s'jam i mirë as t'i sglith
ripet e këputsëvet.

Burra vëllezër, bij të farës s' A-
bramit e atâ ndër jush që i trëmbij
t'in'Zoti, neve na kle dërguar FIALA
e shpëtimit. Atâ që jesiën Jerusa-

lîm e të Parët e 'tire ngê njohën
Atê për atê që ishë , e , pa ndël-
guar, mbaruan të thënat e Profetra-
vet që atâ kishën gjegjur të sgli-
dheshën nga e Shtunie, e pa gjetur
shkak mortie , i lipën Pilatit t'e
dënoj për të vdekur.

Kështu , si mbaruan gjithë atë që
kishë klënë shkruar mbi Atë, e sçri-
pën nga druri dhe e vun te varri.

Po Perëndia e ngrëjti nga të vde-
kuritë . E Ai për disa ditë u'ftua
atireve që kishën jardhur me Atë
nga Galilea në Jerusallim e që nani
janë deshmëtarë të 'Tij në mes s'
popullit. E na ju lajmërojëm juve
se e taksura bër atëravet kle mba-
ruar.

Këtë të taksurë e mbaroi Perëndia
bijëvet t'anë tue ngjallur Iisuin .

Theofania ORA e PARE

Vangjeji Mt. 3,1-6

v.f.198

ms. 118

Ndrekjë hapet...f.19

Trisajon Se jotia isht ...

K o n d a k j i o n

Te valat sot të Jordhanit
vien in'Zot e Janit i thot:
mos u mba të më pagëzosh,se
U jerdha Adhamin të shpëtoja.

lipisi,o Zot ... (40)

O Zoti Krisht... f.20.

lipisi,o Zot..Tij më të
nderoshme ...f.21.

mbë embrin e t'in'Zoti be-
kona;o At.

Theofania ORA e PARE

I Madh'in'Zot na mëshiroft
e na bekoft e na dëftoft fa-
kjen e 'Tij e paçit lipisi
për ne .

O Zoti Krisht Drita... f.22.



Theofania ORA e PARE

*g*****

O R A e T R E T E

Bekuar kloft ...

Lëvdi Tij... Rregji i kjël-
liës ...

Trisajon Se jotia isht rre-
gjëria...

Ejani t'i falemi ... v.f.3&4

Ms. 28

Kjellni t'in'Zoti, o bij të
Perëndis, kjellni kjenkje t'i-
në Zoti.

Ipëni t'in'Zoti lëvdi e nder; ipë-
ni lëvdi embrit t'Tij, përmisij t'
in'Zoti te oborri shejt i 'Tij.

Zëri i t'in'Zoti ë mbi ujërat; u
ndie bumbullima e Perëndis s'lëv-
dis. In'Zot mbi shumë ujëra.

Theofania ORA e TRETË

Zëri i t'in'Zoti me fukjli;
zëri i t'in'Zoti me madhëri .

Zëri i t'in'Zoti çan dëlli-
njat . Dëllinjat e Libanit in'
Zot ka t'i çanjë.

Ka t'i bënë të kërtsejën si vi-
çi i Libanit e Larionin si viç
njëi briu.

Zëri i t'in'Zoti ndan flakën e
ziarrit. Zëri i t'in'Zoti shkund
shkretirën. Ej, in'Zot do t'e shku-
ndënjë shkretirën e Kadesit.

Isht zëri i t'in'Zoti që bën të
lehen më para drerët , që dësh py-
llet e te faltoria e 'Tij kush-dò
i jep lëvdi t'in'Zoti.

In'Zot isht Ai që lëshon shirat,
po rri ujur mbret për gjithë monë.

In'Zot ka t'i japënjë fukjli po-

pulli t'Tij; in'Zot ka t'e bekonjë
në pakje .

Ms. 41

Si dishiron dreri kronjet e ujë-
ravet, kështu shpirti jim dishiron
Tij, o Perëndi.

Shpirti jim ka etën e Perëndis,
e të Fukjishmit, e të Gjallit.

Kur ka t'vete e t'i dëftonem fa-
kjies s'Perëndis?

Lotët t'ime m'u bën bukë ditë e
natë, se gjegjem të më thenë nga
ditë: ku isht Perëndia jit ?

Kujton këtë e derth shpirtin t'im
brënda meje, pse do t'shkonjë te
vendi i tendës të famasëshëme, nje-
ra te shpia e Perëndis në mes s'zë-
reve hareje e këndimeve kremti-
mi.

Përçë je me lipë, shpirti jim?
E përsë trazone ?

Shpresò tek in'Zot; se edhë u
dua t'e lëvdonjë Atë që ë sh-
pëtimi i vetëhës s'ime e Pe-
rëndia jim.

Shpirti jim trazonet brënda
meje, prandaj ka t'kujtonj Tij
nga viset e Jordhanit dhe e
Hermonit, nga mali i vogël.

Duket skurse një juvarë thë-
rret jetrën me zërin e katara-
tëvet.

Gjithë valat të LARTA, gjithë
suvalat shkuan mbi mua.

Ditën mbaron in'Zot lipisin
e 'tij mbi mua e natën u po E
lëvdonj.

Tue E lëvduar u I lutem Perën-

dës i gjellës s'ime e I thom:
Ti je mbronjësi i jim .

Përçë më harrove e përçë ka
t'nisem gjithë i vrerët se më
shtrëngon armiku ?

Si eshtrat t'imë janë shtipur, armi-
kjët t'imë më kjertojën e më thonë
nga ditë: "ku ë Perëndia jit"?

Përçë je kështu i lipisëm, shpirti
jim ? E përçë më trazon kajakë ?

Shpresò tek in'Zot, se u dua t'E
lëvdonjë Shpëtuesin t'im e Perëndin
t'im.

Ms. 50 v. në fakjie 25.

lëvdi past ... aliluja (3) lipisi, oZot(9)
lëvdi past ...

TROPARII v. f. 75

nani e . . .

Mëma e t'in'Zoti, Ti je..f.29

i d h i o e l a

Dora e drejtë e Prodhromit
e Pagzor, i nderuam mbi gjithë
Profetrat, zu të dridhej si Ai
Të pa Tij, Kjenkji i t'in'Zoti
çë pastron mëkatët e jetës.

I pushtuar nga angështi ulu-
riti: Ngë kudsonj të Të ngas
kriet, o Fiala e Perëndis. Ti
vet më shejtërò mua e më ndrit
o Lipislar, pse Ti je Gjella e Drita
e pakjia e jetës.

Prandaj ka t't'kujtonj...
f.77.

Theofania ORA e TRETE

i d h i o s e l a

Trinia, Perëndia jinë, sot na dëftonet pa të ndajtur. Ati bën deshmi me zë të lart të Birit ; Shpirti i Shejt sdripet si pallumb nga kjielli; Biri uj kriet të pafajshëm Prijesit e tue marrë pagëzimin , si Mik i njeriut, liron njerëzin nga robëria.

lëvdi past ... nani ...

Posa dishiroje t'ishe pagëzuar, jerdhe me kurm, me të veshurën njeriu, te lumi i Jordhanit, o Gjellë - dhënës, sa t'na liroje, o Lipisiar, neve të gënjerë, nga çedò dreri të diallit e të na ndritie. Ahierna pate deshmin nga ATI i jit.

E Shpirti i hjynushëm si pallumb u sdrip nga kjielli.

O i Madh'in'Zot ,Njeridashës,eja

Theofania ORA e TRETE

e banò te zëmbrat t'ona .

prokjiemon:

Të pan ujërat, o Perëndi, ujërat të pan e u trëmbën.

nga profetsia e Isais

I.16-20

Këtë thot in'Zot: lahij e do t'bë-
nij të pastrë. Hekjëni të kekjiat
t'uaja përpara Meje nga zëmbrat t'
uaja e sosënie të bëni të kekjiën.
Mësoni të bëni gjithëmonë të mirën,
kërkoni të drejtën, lironi kë ka pa-
sur bër padrejtësi, bëni ligjë të var-
fërit, mbëroni të ven në gjykjë.
Ejani e le t'bisedojëm bashkë, thot
in'Zot.

E në mëkatë t'uaja janë të kukje
purpurë , do t'i bënj të bardha si
sborra, e në janë të kukje kermëz do

t'bënen si leshët.

Në ju doni e më mirrëni 'veshë do t'hani të mirat e dheut. Po në ngë doni e ngë më mirrëni 'veshë, shpata do t'ju prishënjë. Se goja e t'inë Zoti tha këtë .

Nga TE BEMAT e APOSTOJVET

XIX, 1-8

Streksi pra se si Apollos ishë në Korinthë ,Pali pas të shkuarit viset të sipërmë, jerdhi në Efes e si gjeti atjê tsa dsënësë, i tha atireve. Kur ju patët Besën, e mua--rët Shpirtin Shejt ?

E atà u përgjegjën: As kemi gje - gjur kurr se ë një Shpirt i shejt !

E Pali pameta: atëherë në çilin pagëzim u pagëzuat ?

E atà: me pagëzimin e Janit .

E Pali: Jani pagëzoi një pagëzim pendesie tue thënë popullit të kishën besë tek Ai që ki't'vij, vien më thënë te Iisù Krishti.

Si gjegjën këto fialë, u pagëzuan në embrin e t'in'Zoti Iisù .

E Pali ahierna i vuri sipër duart e Shpirti i Shejt jerdhi mbi atà e zun të flisiën gluhët e të profetojën. E gjithë këta burra ishën si dimbëdhietë vetë.

E VEJ TE SINAGOGA e për tre muaj i foli haptas atireve tue i mbu - shur mendien me shërbiset e Perëndis .

Vangjeji Mk. I, 1-8

v.f.199.

Zoti Perëndi ...34

Trisajon Se jotia isht rregjëria...

Theofania ORA e TRETE

KONDAKJION: Te valat... f.82

lipisi, o Zot (40)

o Zoti Krisht... f.20

lipisi, o Zot (3)

Tij më të nderoshme... F.21

mbë embrin e t'in'Zoti, be-
kona, o Zot

I Madh'in'Zot na mëshiroft
e na bekoft e na dëftoft fa-
kjen e 'Tij e paçift lipisi
për ne.

O Zoti Perëndi... f. 35.

ORA e GJASHTETE

Bekuar kloft ...

Lêvdi Tij ... Rregji i kjielliës
Trisajon Se jotia isht rregjëria

Ejani t'i falemi... v.f. 3 & 4

Ms. 73

Përsè, o Perëndi, na rreshte për
gjithëmonë e u ndez zëmërimi jit
kundra delevet e kulloties t'ënde?

Kujtò popullin që Ti bëre jiti që
në të zënit fill.

Lirove shkopin e trazhgimit t'ënt,
malin e Sionit që Ti bëre ndenja
jote.

Theofania ORA e GJASHTETE

Ngre duart t'ote mbi madhështin
e 'tire për të e sosur; sa të ke-
kjë bë armiku jit te Shejtoria
jote !

Si të bëneshën nderime, atà që Të
kishën mbëri lëvdoneshën.

Për flamure vun flamuret e 'tire
e ngë e ndëlguan.

Në të dalurit të sipërm, si në
pyll drunjesh, me sopata çajtën
diert; i shtun te dheu me sopata
e me sakitsa.

I dhanë ziarr Shejtores t'ënde;
shtun te dheu Ndenjën e embrit
t'ënt.

Atà e gjëria e 'tire thanë te zë-
mbra e 'tire ; ejani , le t'e sosi-
ëm mbi dhe me këta nderime Perën-
dës.

Ngë pam më flamuret t'anë; ngë

Theofania ORA e GJASHTETE

ndodhet më një Profet; ngë njihemi
më.

Njera kur, o Perëndi, ka t'vazhdo-
një armiku të shanjë ? Të nëmënjë
armiku embrin t'ënt për gjithëmo-
në?

Përsë Ti hekj dorën tënde e të
drejtën t'ënde e mban gjithëmonë
mbi krahërorin?

Çë moti Perëndia ë rregji jinë e
vepëroi shpëtimin në mes s'botës.

Ti me fukjin ndajte dejtërat; Ti
drëmove krerat e drangonjëvet mbi
ujërat.

Ti shtipe kriet drangoit e ja
dhe për të ngrënë popullit Etiop.

Ti bëre të leleshën burime e për-
ronje, Ti thajte lumet e Ithanit.

Jotia ë dita; jotia isht nata. Ti
bëre hënëzën e natën.

Ti i vure gjithë kufimet botës;
verën e paraverën i bëre Ti.

Kujtò këtë: armiku shan t'ën'Zonë;
një popull i pa tru nëm embrin t'ënt.

Mos lërë bishavet të ëgëra shpir -
tin e atireve që Të lëvdojnë; shpir-
trat e krientullavet t'atë të mjerë
mos i harrò për mot monë.

Mbaje n'mend dhiatën t'ënde, përcë
gjithë angonët e errëta e dheut ja-
në të plota me shpi të kekjie.

Kush isht i përujur mos u turpë -
roft. I vapëku e i mjeri ka të lëv-
dojnë embrin t'ënt.

Ngreu, o Perëndi, mburò gjikimin
t'ënt; kujtò si i lëni Të shan gji-
thë ditën.

Mos harrò zërin e shërbëtorëvet
t'atë ; madhështia e atireve që të
mbajën mbëri isht e ngrëhet gjithë
monë.

Ms. 76

Me zërin t'im u ulurita t'in'Zoti
me zërin t'im thërrita Perëndin t'im
e më vuri 'rë.

Te dita e helmit t'im u kërkova
t'ën'Zonë; natën u ngrëjta duart t'
ime përpara Atij e ngë u gënjeva .

Shpirti jim ngë deshi t'jerë ngu-
shullime ; u kujtova nga in'Zot e
u gëzova; në prapë i mendonj, shpir-
tit t'im i vien si zall.

THEOFANIA ORA e GJASHTETE

Çë më para syt t'imë zun të mos
mbilleshën ; u trazova e ngë fola
më.

Prapë mendoja ditët të motçme ;
kujtoja ditë çë ngë sosiën kurr.

E mejtoja, natën prapë i mendoja
e shpirti jim vej tue skalisur .

'Omse in'Zot do t'na rreshtënjë
për gjithë gjellën e ngë ka t'det
më të na vërrenjë me sy të mirë.?

Do t'ket sosur lipisia e 'Tij?
Ngë ka më fukjll fiala e 'Tij brez
pas brezi ?

'Omse do t'harronjë in'Zot të
ket lipisi e do t'mbillënjë te mbë-
ria e vet mëshirët e 'Tij?

E thash: nani zura të ndëlgoja:
këtë ishtë të ndërruarit e të Drej-
tes e të Lartit.

Theofania ORA e GJASHTETE

Kujtonj gjithë atë çë na ka bër
in'Zot.Famasmët e 'tij çë nga të
zënit fill më vijën në mend.

U do t'mejtonj mbi gjithë veprat
e 'Tij e do t'bie përpara syvet pu-
nët e 'tij. O Perëndi, te shejtëria
dhromi i JIT.

Çili Perëndi ishtë i mathë si Pe-
rëndia jinë? Ti je Perëndia çë bën
famasmë!

Bëre të njihej në mes s'popujvet
fukjia jote; lirove me krahun t'ënt
popullin t'ënt , të bijtë e Jakobit e
të Josefit.

Të pan ujërat, o Perëndi, të pan
ujërat e u trëmbën; u shkundën a -
bisset.

Një zhaurrim i mathë ujërash; mje-
kughat dhanë zë.

Theofania ORA e GJASHTETE

Shi' shkojën shigjetat t'ote;në çë-
dò anë u ndie zëri i bumbullimës.

Shkreptimat t'ote ndritën Botën;
u shkund dheu, u droth .

Udha jote në dejt; dhromet t'atë
në mes s'ujëravet të shuma e gjurmët
t'ote ngë do t'njihen .

E prijte si dele popullin t'ënt
pr'anë të dorës s'Moiseut e të Aaro-
nit.

Ms. 90 v. f.42.

lëvdi past ... Aliluja (3)

lipisi,o Zot ... (3)Lëvdi past...

troparii v.f.75

nani ... theotokjii v.f.45

Theofania ORA e GJASHTETE

i d h i o n e l a

Këtë thot in'Zot Janit:Pro-
fet,eja e më pagëzò Mua,Kri-
uesin t'ënt çë me Dhuratën
ndrit e pastron gjithënjeri.

Ngit kriet t'im të hjynushën
e mos ngurrò. Profet,le t'jes;
përçë U jerdha sa të mbaroja të-
rë drejtësin. Mos ndyshò fare pse
U kam vrap'të vras armikun çë fshi-
het te ujërat,krietarin i të errë-
tit e t'lironjë nani nga dredhit
e 'tij jetën tue i dhënë asaj,te
dashuria jime për njerëzitë,gjellën
e pasosme.

Prandaj ka t'kujtonj Tij
nga viset e Jordanit dhe e
Hermit,nga mali i vogël.

Theofani ORA e GJASHTETE

Sot profetsia e msalmit shpejton të mbaronet se ai thotë dejeti pa e jiku. Jordhani u pruar prapa nga fakjia e t'in'Zoti, nga fakjia e Perëndisë s'Jakobit që vien si shërbëtuar të lipënjë pagëzimin sa na lajturë nga fëllikjëria e idhujvet të kemi nga Ai dritën.

lëvdi ... nani ...

Përçë kjëndrove ujërat, o Jordhan?

Përçë mban të rriedhurit e ngë vazhdon të rriethësh te vija jote ?

Ngë mëndë të duronj, i thotë ai, zarrin që më gris, ngë jam vaditur të lanjë të pastrin, ngë mësova të laja atë që ë pa mëkatë, po të laja enë të ndyemë. Krishti që u pagëzua tek unë mëson të djek glëmbat e mëkatëve.
vet.

Theofania ORA e GJASHTETE

prokjiemenon: Zëri i t'in'Zoti
mbi ujërat.

Kjellnit'in'Zoti
o bij të Perëndisë, kjellni
ni kjenkje t'in'Zoti.

ms.28,3,1.

nga Profetsia e Isaia
XII,1-5

Mirrëni ujë me gëzim nga
burimet e shpëtimit.

E do t' thuash atë ditë: lëvdoni
t'ën'Zonë, thërrini emrin
e 'tij.

Shpallni te gjithë kombet lëvdi
e 'tija; kujtoni se u lartësua embri

THEOFANIA ORA e GJASHTETE

i 'tij. Këndoni emrin e 'tij se bëri gjëra të larta. Thoni këtë te gjithë jeta. Gëzonij e bëni harë ju që jëni në Sion, se u lartësua Shejti i Israelit në mes s'saj.

nga letra e Sh.Palit

ROMANEVET

VI, 3-11

Vëllezër, ngë dini se sa u pagëzuan në Krisht, u pagëzuan në vdekjen e 'Tij?

Andai me pagëzimin në vdekjen e 'Tij, na klem varrëzuar bashkë me Atë; sa ashtu si Krishti u ngjall së vdekurish për lëvdi të të Jatit, ashtu edhe na të jetsiëm në një gjellë e re. Pse në na u bëm gjithë njëi naturie me Atë në të glarit e vdekjes, do të

Theofania ORA e GJASHTETE

jemi kështu me Atë edhe në të glarit e të ngjallurit. Se dim këtë: se njeriu jinë i vietër kle vënë n'krikjë bashkë me Atë sa t'shkatarronej kurmi i mëkatës. Përçë ai që vdes ë liruuar nga mëkata. E në na vdikjëm me Krishtin, kemi besë se edhe do t'rronjëm me Atë. Pse dim se Krishti, posa u ngre së vdekurish, ngë vdes më, vdekjia ngë e zotëron më. Pse, të ket vdekur Ai, vdikjë për mëkatën, po një herë vetëm. E të rronjë, Ai rron për Perëndin. Ashtu edhe ju të ndëlgo - nij si të vdekurë mëkates, po të gjallë për Perëndin tek in'Zot Iisù

K R I S H T I .

V a n g j e j i

Mk. I, 9-11 .

Tek ai kjërë Iisui jerdhi nga Nazarethi i Galilës e kle pagëzuar

Theofania ORA e GJASHTETE

nga Jani te lumi i Jordhanit.

E njëherie, si dilëj nga ujët,
pa kjielliat të hapeshën e Shpirtin
si një pallump që sdripej mbi
Atë. E një zë jerdhi nga kjielliat:
Ti je im Bir i dashuri, që më
pëlkju.

Le mëshirët t'ote...v.f.52

Trisajon Se jotia isht ...

kondakjion: Te valat sot...f.82

Lipisi, o Zot (40)

O Zoti Krisht... f. 20.

Lipisi, o Zot (3) Tij më tënderosh-
me ... f.21 Mbë embrin e t'in'Zoti,
bekona, o At.

I Madh'in'Zot na mëshiroft e na
bekoft e na dëftoft fakjien e 'Tij

Theofania ORA e GJASHTETE

e paqiet lipisi për ne .

O Perëndi e Zoti i fukjivet e
Kriues ... f. 53.

*

ORA e NENDETE

Bekuar kloft...

Lêvdi Tij ...

Rregji i kjielliës

Trisajon Se jotia isht rregjëria
f.3 & 4

Ms. 92

Perëndia rregjêron; u pështrua
me madhëri, u rrethua me fukji.

E kështu dheut i dha kjëndresë:

e s'do t'tundet.

Gàti ê throni jit që ahierna; që më para Ti je .

Ngrëjtën lumet,o i Madh'in'Zot, ngrëjtën lumet zëret e 'tire.

Të famasëshme suvalat e dejtiti, po sa më i famasëshëm in'Zot te të lartitë kjlej.

Deshmimet t'atë janë shumë të besuarshmë.

Shpis s'ate i përket snejtëria,o Perëndi,për ditë të glata.

Ms.113

Kur Israeli dolli nga Egjipti e të bijet e Jakobit ngë gjegjën më gluhë të huaja,

In'Zot mori Judhën për falto-
re të 'Tij e Israelin për zo-
tëri e 'Tij.

Dejti pa e jiku.Jordhani u
pruar prapa. Ku je ti,dejt,çë
jike? E ti Jordhan që u prore
prapa ?

Malet kërtslen si deshë,kod-
rat si katsikjë.

Përpara rækjies e t'in'Zoti
u shkund dheu,përpara Perën-
dis s'Jakobit .

T'Atij që ndërroi gurin në likjer,
shkëmbin në burim ujërash.

Jo neve,o i Madh'in'Zot,jo neve,
po ëmbrit t'ënt jip lëvdë për li-
pislën t'ënde,për vërtetien t'ënde.

Sa mos të then kombet: ku isht Pe-
rëndia i 'tire ?

Perëndia jinë isht në kjiell e në dhe. Aì bë gjithë atë që deshi.

Idhujitë e kombëvet janë 'rrgjënd e ar , vepra e duarëvet e njerëzëvet .

Kanë gojë e ngë flasiën; kanë sy e ngë shohiën.

Kanë duar e ngë ngasiën; kanë këmbë e ngë jetsiën; ngë i del zë nga grika e ' tire.

U bëfshin njësoj atà që i bën e gjithë atà që shpresojën tek atà.

Shpia e Israelit shpresoi tek in' Zot; Aì i mbron e i ndih.

Atà që i trëmben t'in'Zoti kanë shpresuar tek Aì; Aì isht ndihma e mbronjësi i 'tire.

In'Zot na kujtoi e na bekoi.

Bekoi shpin e Israelit; bekoi shpin e Aaronit.

Bekoi atà që i trëmben t'in'Zoti; të mëdhenjë e të vegjij.

Shumësoshit lipisit e 'tij in'Zot mbi ju e mbi bijët t'aj.

Klofshit bekuar nga in'Zot që bëri kjielliën e dheun.

Kjielli ë kjiell për t'ën'Zonë; po dheun Aì ja dha të bijëvet e njerëzëvet.

Ngë janë të vdekuritë që ka lëvdojën t'ën'Zonë; as atà që sdripen në varr.

Po na të gjallë do t'bekojëm t'ënë Zonë që nani e njer mot monë.

Theofania ORA e NENDETE

Ms 85 v.f. 58

lëvdi... Aliluja (3) lipisi, Zot..

Lëvdi...

Troparii v.f. 75

nani...

theotokjii v.f. 61

i d h i o m e l a

Çudhi e madhe të parit Bëresin i kjelelliës e të dheut si shërbëtuar të marrënjë pagëzi min mbë likurë te lumi nga shërbëtori i 'tij. Koret e Engjëjvet u famasën të dreruamë e të gëzuarë .

Bashkë me atà na të përmisemi:shpëtona, o i Madh'in'Zot.

Prandai ka t'kujtonj Tij nga

Theofania ORA e NENDETE

viset e Jordhanit dhe
t'Hermonit nga mali i vogël.

Kur Prodhromi pa t'i vij përpara
Zoti i lëvdës , uluriti:Shi' jerdhi
Ai që ka t'lironjë jetën nga prishëria. Shi': Ai na shpëton nga helmi.

Paj t'lipisi që ka për ne na vien te jeta nga Virgjëra tue dhuruar ndëjesën e mëkatëve. Në vend shërbëtorësh Ai na bën bij të Perëndisë. Me ujët e pagëzi - mit t'Tij të hjynushëm Ai i jep dritën njerëzëve. Andai ejani e lëvdonie të gjithë me një zë bashkë me Atin e me Shpirtin Shejt.

lëvdi... nani...

Me dorën tënde Ti ngave
kriet të t'in'Zoti .

E me glishtin e asaj dorie Ti

Theofania ORA e NENDETE

na E dëftove neve .

Ndeje nanë atë dorë Atij, për ne,
se Ti ke kudsim të mathë përpara
Atij.

Ti nga Ai kleve deshmuar si më i
Madhi i Profetravet.

Edhë ata sy vet çë pan Shpirtin
Shejt të sdripej mbi Atë si pallump,
Ti nanë priri nga Ai, për ne, sa të
na ket lipisi.

Eja e rri me ne

të vulosësh kënkën t'ënë e të
zësh kremtimet t'anë .

prokjimeni: In'Zot drita jime, shpë-
timi jim. Kuj ka t'i trëm-
bem?

In'Zot mbronjësi i gje-
llës s'ime: kush mëndë të
më dreronjë ?

Theofania ORA e NENDETE

nga profetsia e Isais 49,8-15

..Këte thot in'Zot: në kjërò të për-
shtatshëm U të gjegja e në ditë sh-
pëtimi U të ndiha e të gjësja e të
dhash për dhiatë gjithë popujtë sa
të ndërtoesh prapë dheun, të shpërblesh
trazhgimin e shkretirëvete të thuash
robëvet: **dilni** e atireve çë janë te
të më të errëtitë: **ejani te drita.**

Në çëdò udhë do t'gjejën gjër, do të
kullotiën mbi gjithë kodrat, ngë do
t'riejën url a etë, ngë do t'jen mun-
duar nga vapa a nga dielli. Pse Ai
çë i pati lipisi ka t'i ngushëllonjë
e ka t'i kjellënjë nëpër kronje ujë-
rash . E gjithë malet do t'i bënë
udhë e çëdò udhë vend kullotie.

Shi' këta ka t'vijën prej së largu,
t'jerë nga veriu a nga perëndimi, t'
jerë edhë nga dheu i Persianëvet.

Theofania ORA e NENDETE

Le t'bëjën harë kjielliat, le të gëzonet dheu. Shpërthënshin malet gëzimin e pyllët drejtësin, përçë Perëndia pati lipisi për popullin e 'tij e ngushëlloi të mjerët te gjindia e 'tij.

Thot Sion: In'Zot më la, In'Zot më harroi. Po mëndë kurr një mëmë të harronjë fëmijën e 'saj e mos të ketë mëshirë për pemën e gjirit t'saj ?

E edhe në ajo t'e harroft, ngë mëndë të t'harronjë kurr U, thot

IN'ZOT i gjithëmëndëmi.

nga litra e Sh. Palit Titut
II, 11-14; III, 4-8

Tit bir, u dëftua Dhurata e Perëndisë shpëtuese për gjithë njerëzitë, e çila na mëson të rrojëm, pas të mohuarit pa-

Theofania ORA e NENDETE

besërin e dëshirët e jetës me urtësi e drejtëri të këjo jetë tue pritur të lumen shpresë e të dukurit e lëndës e të Madhit Perëndi e Shpëtuesit t'ëne Iisù Krishtit, i çili u dha për ne sa t'na liroj nga çëdò paligjësi e sa t'pastroj për 'të një popull të sgledhur e me zëmëren e përvluarë për të bëmat të mira.

III, 4: Kur u pra u dëftua mirësia e dashamirësia e Perëndisë Shpëtuesit t'ënë, Ai na shpëtoi e jo paj të vepravet të drejta çë bëm na, po paj të lipisës s'Tij, pr'anë të të lajturit e rilindies e të t'përtërijturit e Shpirtit Shejt çë Ai derdhi me burë mbi ne pr'anë të Iisù Krishtit Shelbuesit t'ënë: sa të dal të drejtë paj të Hirit t'Tij, të bënemi trazhgimtarë me shpresën e gjellës s'pasosme.

Vangjeji Lk. III,1-18

v.f. 201

Paj t'embrit t'ënt...

f. 67.

Trisajon Se jotia isht rre-
gjëria ...

Kondakjion v.f. 82

Lipisi, o Zot (40)

O Zoti Krisht ... f. 20

Lipisi, o Zot (3) Levdi past..

Tij më të nderoshme...

mbë embrin e t'in'Zoti,
bekona , o At.

I Madh'in'Zot na mëshiroft
e na bekoft e na dëftoft fa-
kjen e 'Tij e paçit lipisi
për ne .

O i Zot e Zot Iisù ... f. 68.

Lëvdi Tij, o Krisht Perëndi,
shpresa e gjithë neve, paçe lëvdi.

Lëvdi past....

LIPISI, o ZOT (3) Ati shejt, bekò.

Krishti i vërteti Perëndia jinë
paj të dëlirës Mëma e 'Tij, paj të
lëvduashmëvet të famëshme Apostoj,
e paj të gjithë Shejtravet na paçit
lipisi e na shpëtoft si i Mirë e
njeridashës.

Paj të lutievet e Shejtravet Atë-
ra t'anë , o Zoti Krisht Perëndia
jinë, kijna lipisi, amin .

tek e

PREMPTIA EMADHE

ora e pare

bekuar kloft

Lëvdi Tij... Rregji i kjiell-
ës që na përgëzon

Trisajon Se jotia isht rre-
gjëria ...

Ejani t'i falemi ... ff.3,4

Ms. 5 V, f. 5

Ms. 2

Përçë gjindet tërbonen, e po-
pujitë vën në mend të kota?

Ngrëhen rregjërat e dheut,

E Prëmptia e Madhe ORA e PARE

e përzihen bashkë të Parët sa
të vën ballë me Perëndin e me
Krishtin e 'Tij ?

Këputiëm-thonë atà-lidhiet e
'tire e shtiem larg nesh sgje-
dhën e 'tire.

Al që jet në kjiell ka të kje-
shënjë mbi 'ta, e in'Zot ka t'i sha-
një.

Atë herë ka t'i flasënjë atireve
te mbëria e 'tij, e te tërbimi i 'ti
ka t'i llavënjë.

Por U kleva vënë n'krikjë nga Al
mbi malin e Sionit ku isht Shejtë-
ria e 'Tij sa t'shtiell urdhurimin
e Perëndis.

Perëndia më tha mua : im Bir je Ti,
U sot Tij të kam ler .

Ti Mua lipëmë e U. kam të t'jap Tij

E Prêmtia e Madhe ORA e PARE

trazhimin t'ënt gjindet e të pasurën
t'ënde këndet e dheut.

Sa t'i kullotësh me shkop hekuri,
e sa t'i drëmosh, si poçe botie.

E nanë ju rregjëra, të vëni tru:
mësonij, ju të gjithë që gjikoni je-
tën.

Shërbeni Perëndin tue u trëmbur,
e gëzonij me 'të tue u dreruar.

Mirrëni mësimin, mos të mbrihet
Perëndia, e mos ju të sbirij jash-
ta dhromit e drejt.

Kur edhë pak të dhizet mbëria e
'Tij: të lumë gjithë atà që kanë
shpresë tek Ai .

E Prêmtia e Madhe ORA e PARE

Ms. 21

O Perëndi, Perëndia jim, priru ngak
u; përsë më le ?

Lark je Ti nga të shpëtuarit mua
e nga fialët e ulurimës s'ime .

O Perëndia jim, u të thërres ditën
e ngë më gjegje; të thërres natën
e ngë më vë 're.

Po Ti jes te Shejtoria, lëvdia e Is-
raelit. Tek Ti shpresuan atërat t'a-
në e Ti atà i lirove .

Të thërritën Tij e klen shpëtuar;
shpresuan tek Ti e ngë klen të tur-
përuar.

Po u jam si një krimb e jo njeri:
dhuna e njerëzëvet; i përkjeshur
nga gjindia.

Gjithë atà që më shohiën, kjeshiën

E Prëmtia e Madhe ORA e PARE

MBI MUA ,dredhiën buzët,tujën kri-
et.

Shpresoi tek in'Zot,thonë,le t'e
shpëtonjë Ai,posa ëe do mirë.

Pse Ti je Ai që me hokje nga gjiri;
Ti shpresa jime që nga sisët e mëmës
s'ime.

Që Cë më para se të lehesha kleva
truajtur Tij e nga gjiri i mëmës s'
ime Ti je Perëndia jim; mos u largò
ngak u .

Se helmi më shtrëngon; ngë kam nje-
ri të më ndihënjë.

Më kjarkuan shumë kje;demë të fortë
më rrethuan.

Kundra meje sbillën gojën si luan
që rrëmben e ulurën.

E Prëmtia e Madhe ORA e PARE

U derdha si ujë e u shprishën gji-
thë eshtrat t'imë.

Zëmbra jime u bë si dillë që joset
në mes s'barkut t'im.

U ter fukjia jime si poçe botie e
gluha jime m'u ngjit grikës e më
kjelle te plëhtë e morties.

Se më kjarkuan shumë kjen;mbëledhie
kekjëbërësësh më rrethuan.

Më shpuan duar e këmbë;nëmëruan
gjithë eshtrat t'imë.

Shtun syt mbi mua e më veshtrojën.

Ndajtën pethkat t'ime ndër 'ta e
mbi rrobikun shtun shortën.

Po Ti,o i Madh'in'Zot,mos largò
ndihmën t'ënde prej meje.Eja anan-
gasu të më ndihësh.

E Prëmtia e Madhe ORA e PARE

Ruaj nga shpata shpirtin t'im e
të vetëmin-ler t'im nga dora e kje-
nit.

Shpëtona nga goja e luanit e mje-
rën t'ime nga brit e kafshavet njëi
briu.

U do t'lëvdonj embrin t'ent në mes
s'vëllëzërëvet, dua t't'këndonj në
mes s'mbëledhies.

O ju që doni mirë t'ën'Zonë, lëvdo-
nieq gjithë fara e Jakobit ipëni
nder Atij.

Çëdo bir t'Israelit le t'i trëmbet
pse Ai ngë e hodhi posht; ngë e për-
buzi lutien e të vapëkut.

Ai më prori fakjien mua e si u e
thërrita, Ai më gjegji.

Lëvdimi jim përpara Teje te mbële-
dhia e madhe do t't'madhëronj; do të

E Prëmtia e Madhe ORA e PARE

bënjë lutiet t'ime përpara atireve
që i trëmben.

Të vapëkjite do t'han e të tsiten;
e atë që e kërkojnë do t'e lëvdojnë
t'ën'Zonë. Zëmbat e 'tire do t'rro-
jnë për mot monë.

Gjithë jeta do t'e mendonjë e kat
priret tek in'Zot e gjithë gjindet
do t'i përmisen, pse rregjëria isht
e t'in'Zoti. Ai zotëron mbi gjithë
kombet.

Hëngrën e peoskjinisën gjithë kom-
bet e dheut; Atij do t'i përmisen
gjithë atë që sdripen në botë.

E do t'rronjë shpirti jim e fara
jime do t'i shërbenjë Atij.

Jinia e ardhshme do t'jet për t'ënë
Zonë e do t'lajmëronjë drejtësin e
'tij popullit i ri që s'glochi IN'ZOT.

Lëvdi ... nani ... aliluja (3)

Lipisi, o Zot (3) Lëvdi past...

Vënë n'krikjê Ti, o Krisht, kle he-
kjur tiranla, kle shtipur fukjia e
armikut. As Engjëjitë, as njeriu,
po Ti vet, o i Madh'in'Zot na shpë-
tove neve. Ti paçe lëvdi!

nani ... Si ka t't'thërresiëm...f.13

st. i d h i o e l a

Sot villi i faltores shkjinret sa
të ngalesënjë të paligjët e dielli
fsheh rrezet e 'tij si sheh t'ënë
Zonë vënë n'krikjë.

Përçë gjindet tërbonen e po-
pujitë vën në mend të kota ?

Si një dele je kjellur t'jesh ther-
tur, o Krisht Rrekjê e si kjenkjê i
pafajshëm je gozhduar te krikjia nga
të paligjët për mëkatët t'ona, o Mik
i njeriut.

lëvdi ... nani...

Të paligjëvet çë të muarën i duru-
ashëm, kështu thëshie, o i Madh'in'Zot
Edhë të kini goditur Delmerin e sh-
prishur të dimbëdhietat dele, dsënë-
sitë t'imë, U mëndë bëja të vijën
më shumë se dimbëdhietë legjonë En-
gjëjish, po dua të jem zëmërmathë
sa t'mbaronen misteret të fshehurë
çë ju paralajmërova pr'anë të Profe-
travet. O i Madh'in'Zot, paçe
lëvdi !

E Prëmtia e Madhe ORA e PARE

prokjiunenon: Dilëj jashta
e shpejt flisëj kundra Meje.

E kundra Meje
murmurisiën gjithë armikjët t'i-
më; kundra Meje mendojën të kekjia

I lum ai njeri që
ka kujdes për të vapëkun e përtë
njerin; te dita e ligë do t'e shpë-
tonjë i Madh'in'Zot.

nga profetsia e Zaharis

xi,10-13

Thot in'Zot: e ka marr shkopin
i mirë e ka t' e bënëj tsopa tsopa
sa t'shkljerr dhiatën që bëra me
gjithë popujitë/.E tek ajo ditë dhi-
ata ka t'sosënjë e Kananenjët ka t'
jen njohur si dele ruajturë ngak U.
Këjo isht fiala e t'in'Zoti !
E atireve do t'i thom: në ju duket

E Prëmtia e Madhe ORA e PARE

DREJT , më jipëni rrogën,ndryshe le-
ni t'jes. E vendosën rrogën t'ime
tredhietë 'rrgjëndë. E më tha inë
Zot: vëri te honevtirii e U do t'shon
në kleva çmuar drejt nga atë.

E mora tredhietë rrgjënditë e i vu-
ra te shpia e t'in'Zoti,te honevti-
rii.

nga litra e Sh. Palit Galatianëvet

VI,14-18

Vëllezër, për mua mos mëkloft të
mburrem veç se te krikjia e t'inë
Zoti Iisù Krishtit paj të çilës je-
ta ë krikjëzuarë për mua e u për
jetën.

Pse në Iisù Krishtin ngë vëjën
rrethpresie a parrethpresie,po kri-
esa e re .

Atë që ruajën këtë rregullë e gji-
thë populli i Perëndisë(Ieraeli) pa

E Prëmtia e Madhe ORA e PARE

çin pakje e lipisi.

Çë nani e para mosnjeri të më sh-
kjetësonjë përçë u kjell shengjet
e t'in'Zoti Iisù Krishtit te kurmi
jim. Kloft Dhurata e t'in'Zoti Iisù
Krishtit me shpirtin t'ëj, o vëllezër,
amin.

Vangjeji Mt. XXVII, 1-56.

v.f. 205

Ndrekjë hapet t'imë...

v.f. 19.

Trisajon Se jotia isht rregjëria...

kondakjion:

Ejani të këndojë Atë çë ë
vënë n'krikjë për ne.

Atë vërren Marieja e i thot:
Megjithëse je duron krikjien,
je gjithëmonë BIRI jim!

E Prëmtia e Madhe ORA e PARE

Lipisi, o Zot (40)

O Zoti Krisht Berëndi... V.f; 20 Lipisi(3)

Lëvdi past Tij më të nderoshme...
v.f. 21

mbë ëmbrin e t'in'Zoti, be-
kona, o At.

I Madh'in'Zot na mëshiroft
e na bekoft e na dëftoft fa-
kjien e 'Tij e paçit lipisi
për ne.

O Zoti Krisht, Drita ...f. 22.

E Prëmtia e Madhe ORA e TRETE

O R A e T R E T E

Bekuar kloft

Lëvdi Tij ... Rregji i kji-
elliës ...

Trisajon Se jotia isht rre-
gjzëria ...

Ejani t'i falemi ... f.3&4

Ms. 34

O i Madh'in'Zot, mbrojëmë
nga atà që më bëjnë të kekjë; muj
atà që më luftojën.

Mirr armë e mbronjë dhe ngreu
të më ndihësh.

E PRËMPTIA e MADHE ORA e TRETE

Ndsir shtizën e priti dhromin ati-
reve që më ndjekien ; thuaj shpir -
tit t'im: U jam shpëtimi jit.

Atà që më kërkujën gjellën u trazo-
fshin e ndleshin turp.

U priershin prapa e u sblershin
atà që mendojnë të likë kundra meje

U bëfshin si plëh në fakjie të erës
e Engjëlli i t'in'Zoti i prishëshit

Kloft rruga e 'tire e më t'errëme
dhe e shkjitëshme e Engjëlli i t'in
Zoti i ndjekshit.

Përçë pa pasur likjë më fshehën
një rrietë në gropë; pa pasur shkak
më varesën shpirtin.

Te kurthi le t'bien atà; rrieta që
fshehën për mua le t'i zënjë e le
të sbiren në gropën që atà më gremuan

Shpirti jim do t'gëzonet tek in'zot ;
do t'bënj harë se Ai e shpëtoi.

Gjithë eshtrat t'imë do t'then:
o i Madh'in'Zot,kush ë si ti ?

Si Ti që liron të vapëkun nga du-
art e atireve që janë më të fortë
se ai ; të vapëkun e të urmin nga
atà që dçeshiën.

U ngrëjtën deshmëtarë të likjë që
më plejën atë që ngë dija .

Më prieriën të likë për të mirë;
shkretirë për shpirtin t'im.

Po u ndërsa atà më shkjetësojën,
vëshia thesin e përuja shpirtin t'
im tue argjëruar ,e kurrusesha mbi
gjirin t'im në lutje.

Sillesha me atà si një mik,një vë-
llà e si në lip e trishtim u përu-
njëssha.

E atà dëfreneshën mbi mua e u mbëjodhën të
më rrahiën e u n gë e dija .

U shprishën ,po ngë u penduan; më
ngisiën e më kjeshojën e më grijën
kundra dhëmbët.

O i Madh'in'Zot, njera kur ka t'
rrish tue vërrejtur ?

Lirò shpirtin t'im nga të kekjë-
bërit e 'tire ; shpëtò të vetëmen
e mirë t'ime nga luanët.

U dua t't'lartësonj në mbëledhie
të-mëdha; përpara lusmë gjindeshë
dua t't'lëvdonj.

Mos u gëzofshin kundra meje armi-
kjët t'imë,atà që më mbajën mbërl
pa pasur likjë,tue bër shengje me
syt.

Përcë mua më thëshëjën fialë pa-
kje e ndër 'ta pran të zëmëruarë
flisiën si të më gënjëjën.

E Prëmptia e Madhe ORA e TRETE

Hapiën gojën kundra meje
e thoshëjën: aih, aih, e pan syt t'
anë.

E pe , o i Madh'in'Zot; mos t'rrish
pa folë , mos të rrish largu meje .

Ngreu e më bën ligjë, o Perëndia
jim; o i Zoti jim, mbroj të drejtën
t'ime .

Gjikomë, o i Madh'in'Zot, e Perën-
dia jim, mos ata të gëzonen mbi kra-
hët t'imë.

Mos të then te zëmbrat e 'tire:
u gëzofshit shpirti jinë se e gjë-
llitëm.

U ngukjëshin e paçin turp gjithë
atà që gëzonen me të kekjiat t'ime.

Të pështruarë me dhune e shnderim
klofshin atà që thonë fialë të më-
dha kundra meje.

E Prëmptia e Madhe ORA e TRETE

U gëzofshin e paçin harë atà që
duan të drejten t'ime e thofshin
kurdoherë: 'kloft msdhëruar i Ma-
dh'in'Zot', atà që duan PAKJIEN e
shërbëtorit t'tij.

E gluha jime do t'mejtonjë drejtë-
sin t'ënde e gjithë ditën ka t'e
lëvdonjë .

Ms. 108

O Perëndi , mos më bësh të pusho-
një nga të lëvduarit Tij; pse u sbill
goja e të mëkatruamit e të gënjesht-
arit kundra meje .

Kanë folë kundra meje me gluhë gë-
njeshtare; më kanë rrethuar me fia-
lë mbërie, më kanë luftuar pa pasur
likjë , dhurat ;

Në vend të më dejën mirë më kanë
shpifur; po u kam parkalesur për atà

E prëmtia e Madhe ORA e TRETË

Më kanë dhënë të kekjia për të mirat e urrejtie në vend dashrie.

Vëji sipër një i mëkstruam e diallin t'i rrie tek e drejta.

Le t'dajnjë i dënuar kur t'e gjikojën e lutia e 'tij i kloft për mëkatë.

U shkurtrofshin ditët e 'tija e vendin e 'tij e marshit nj'atrë.

Të varfrë kjëndrofsahin të bijët e e ve gruaja e 'tij.

Vafshin tue rrahur të bijët e 'tij e tue lipur, të shtrënguarë të lën shpit e 'tire.

Ai që huan t'i hëngrëshit gjithë atë që ka e të huajitë u gëzofshin me pemët e punës s'tij.

Mosnjeri u ndodhëshit t'e ndihënjë

~~e mosnjeri o~~

E Prëmtia e Madhe ORA e TRETË

e mosnjeri paçit lipisi për të varfëritë e 'tij.

I klofshin bijët e 'tij prishur; në një jinë u sdukëshit ëmbri i 'tij.

Mos u harrofahit e kekjia e 'jattit t'tij përpara t'in'Zoti e u sdukëshit kujtimi i 'tire nga dheu.

Pse ngë u kujtua kurr të kishë lipisi e ka ndjekur njeriun të mjerë e të vapëk e të piklluar në zëmërë sa t' e vrisëj.

I pëlkej të mallkoj, kloft mallkuar; ngë deshi kurr të bekoj, e bekimi ka t'largonet nga ai.

Kloft pështruar me mallkim si më të veshurë; t'i hijshit si ujë të përbrëndëshmat e 'tij, si vaj te eshtrat.

I kloft mallkimi si e veshurë që e pështron e si rreth që e shtrën-

E PRËMPTIA E MADHE ORA e TRETE

GON.

Ki ka t'jet shpagimi, nga ana e t'
in'Zoti, i atireve që më mbajën mbë-
rë; t'atireve që më mbajën mbëri;
t'atireve që flasiën kundra shpir-
tit t'im.

Po ti, o i Madh'in'Zot, klopshe me
mua paj t'embrit t'ënt, pse e ëmbël
isht lipisia jote .

Liromë, se i vapëk e i mjerë jam u,
e zëmbra jime u trazua brënda mua.

Jam e sdukem si hjeja që shkon;
jam shkundue këtù e këtië si KAR-
kalëts.

Për atà u bëra turp; më shohiën
e tundjën kriet.

Ndihëmë, o i Madh'in'Zot, Perëndia
jim, paj t'lipisis s'ate.

E Prëmtia e Madhe ORA e TRETE

Të njohëshin atà se këjo ë dorajo-
te e se Ti e bëre.

Le të më mallkojën atà, po Ti të më
bekosh; kur t'u ngrëshin, klopshin
të turpëruar; po shërbëtori i jit
ka të gëzonet.

Atà që më ngalesiën klopshin pësh-
truar me dhunë e veshur me mëntin e
turpit.

Me gojën t'ime dua të t'lartësonjë
shumë, o i Madh'in'Zot, e dua të
t'këndonjë në mes s'lusmë gjir-
deSH.

Përçë u vure tek e drejta e
të mjeritdhe e shpëtove nga
gjithë atà që i ndjekiën gje-
llën.

E Prëmtia e Madhe ORA e TRETE

lëvdi... nani ...

aliluja (3) lipisi, o Zot... (3)

lëvdi ...

O i Madh'in'Zot , Judhenjtë dënuan të vdisëj Tij që je Gjella i gjithëve.

Ata që shkuan mbë këmbë dejtin e kukjë ndajtur nga shkopi(jit)të gozhduan te Krikjia. Ata që nga shkëm-

bi pin mjajtë të dhanë Tij tamëth.

Po Ti deshe të duroje gjithë këtë sa t'na liroje nga robëria e Armi-
kut. O Krisht Perëndia jinë, paqe

lëvdi !

nani

Mëma e t'in'Zoti.. v.f. 29.

E Prëmtia e Madhe ORA e TRETE

i d h i o m e i a

Për dren të Judhenjëvet miku jit,
i afërmi, Pietri, të mohoi, o i Madh'
in'Zot, e tue klar kështu ulurij:

Përpara lotëvet t'ime mos kjëndrò
i pa folë. Të thash se ki't'ruaja
ben, o Lipisiar, po ngë e ruajta.

Edhë pendimin t'ënë , o i Madh'in'
Zot, prit mirë e kijna lipisi.

Vëri veshin fialëvet t'ime, o
Perëndi: kuptoje psherëtimin
t'im.

Përpara të çmuames Krikjie ushtar-
rët të kjeshojën, o i Madh'in'Zot,
e Ushtët e kjielliavet ishën të
skotistë.

U kurorëzove me një kurorë të sha-

E Prëptia e Madhe ORA e TRETË

rash Ti që stolise Dheun me lule. E
veshe një mënt të kjesuri Ti që
vesh hapësirën mënjekulla.

Te këta të vepruar t'atë njohiëm
kjelmerin t'ënde për ne, lipisin t'
ënde të madhe .

lëvdi ... nanl ...

Si ishe kjellur t'atë vëjenn'krikjë,
kështu thërrite, o i Madh'in'Zot: Për
të çilën veprë do t'më vëni n'krikjë,
o Judhënjë? Ndoshta për që i dhash
shëndeten të të njomurëvet? 'Omse
për që ngjallia të vdekuritë skurse
i sgjoja nga gjumi? Se shëndosha E-
morolsën? A se m'u duk kekjë grua-
ja Kananë? Për të çilën e bëme doni
të më vrini, o Judhënjë?

Po një ditë ka prini syun t'ëj nga
Ai që nanl shponi, nga Krishti, o
të paligjë.

E Prëptia e Madhe ORA E TRETË

prokjiunenon: Se U jam gati të jem
kësitur e të vuajtu-
rit t'im më të gjithëmonë
përpara.

O i Madh'in'Zot, mos më
kjërtote zëmërimi jit, mos
më mundò te mbëria jote.

Nga Profetsia e ISAIS

50,4-11

In'Zot më dha një gluhë të
të dijturish, më dha tënjoh për që
një ka t'e thet fialën.

Nga menatë më sgjon veshin sa të
gjegjem. Mësimi i t'in'Zoti më sbill
veshin e u e gjegja, ngë e kundrësh-
tova. Parakjita kurrizin t'im sa t'
ishë dërselluar e mollëzat e fakjes
s'ime shplakavet .

Ng'e prora fakjien t'ime nga turpi
i pushtimavet e in'Zot më kle ndihmë.

Prandaj ngë u turpërova , po dhash fakjien si gur i thatë e dija se ngë ki't'kisha turpërçë kjaset kush ka t'më drejtëronjë,ka t'më japënjë likjë.

Kush ka t'më gjikonjë? Le t'më vijnjë përpara. Kusha ka t'më gjikonjë? Le t'kjaset tek u. Shi' in'Zot ka t'më ndihënjë. Kush ka t'më bënëjë të likë ? Shi' se gjithë ju ka t'vje - tronij si të veshurat,shi si kopi - tsa ka t'ju hanjë.

Kush ndër ju itrëmbet t'in'Zoti ? Le t'marrënjë'veshë zërin e shërbëtorit t'tij.

Ju çë jitsëni te të më t'errëtime, çë ngë kini dritë,shpresoni te emëri i t'in' Zoti e te Perëndia do gjeni fukjl.

Shi' ju digjij si ziarr e ja shkonni flakës.Itsëni me dritën e zjarrit t'ëj e me flakën me të çilën u prishët tue djegur. Për mua strek-

sën juve këtë gjëra;do t'kjëllonij në lipë.

nga litra e Shën Palit

R O M A N E V E T V,6-10

Vëllëzër, kur ishëm edhë të liksh-të Krishti në kjërò vdikjë edhë për të pabesmitë.Se ë rrallët për një njeri të drejt nda-një të vdesënjë!

Për njeriun të mirë mënd't'jet kurr nda-njeri të vdesënjë ? Po Perëndia dëfton dashurin e 'Tij për ne,pse, kur na ishëm edhë fajtorë,Krishti vdikjë për ne. Prandaj nanë çë jemi drejtëruar te gjakuthi i 'tij,na mënd't'shpëtonemi nga mbëria paj të 'Tij. Në na pra tue klënë zënë,paj t'vdekjies s't'Birit 'Tij,u pajtuam me Perëndin,më shumë, dha p'ajtuarë do t'jemi shpëtuar te gjella e 'TIJ

E Prëmtia e Madhe ORA e TRETE

Vangjeji Mk. XV,16-41 v.f.

Zoti Perëndi f. 34 213.

Trisajon Se jotia isht rregjëria

kondakjion : Ejani të këndojëm...
f.134.

Lipisi, o Zot (40)

O Zoti Krisht Perëndi f. 20

Lipisi, o zot (3) Lëvdil past...
Tij më të nderoshme f.21

më embrin e t'in'Zoti , beko-
na, o AT.

I Madh'in ' Zot na mëshiroft e na
bekoft e na dëftoft fakjien e 'TIJ
e pa'it lipisi për ne.

E Prëmtia e Madhe ORA e TRETE

O Zoti Perëndi, At i gjithëmën-
dëm, Zoti Iisù Krisht e Shpir-
ti i Shejt , Një Hjyni, Një fu-
kjil, paçe lipisi për mua i më-
katruam e te gjykji që ka t'
mbash snpëtomë mua, të pavëje-
fshim shërbëtuat t'ënt , pse
Ti je i bekuam për jetë të je-
tëvet , a m i n .

ORA e GJASHTETE
E TE PREMTIES S ' MADHE

+

Bekuar kloft ...

Lëvdë Tij... Rregji i kjielliës...
Trisajon Se jotia isht rregjëria

Ejani t'i falemi ...

Ms. 53

O Perëndi, mbë embrin t'ënt shpëtò-
më; me fukjìn t'ënde bëjë më ligjë.

Gjekj, o i Madh'in'Zot, lutien t'i-
me; mirr 'veshë fialët e gojës s'ime

Përçë të huaj u ngrëjtën kundra
meje e të fortë janë atà që më kër-
kojnë gjellën; gjinde që ngë mbajën
Perëndin përpara syvet.

E Prëmtia e Madhe ORA E VI

Po shi' se in'Zot më ndih; in'Zot
m'e mburon shpirtin t'im.

Do t'i prierënjë të likë armikjë-
vet t'imë. Shfarosi me vërtetien
t'ënde .

Me-hir dua t't'bënjë flijë; dua
të lartësonjë embrin t'ënt se isht
i mirë, o i Madh'in'Zot.

Se nga çëdò helm Ti më lirove
e syu jim mëndëti të vërrej armi -
kjët t'ime prej s'larti.

Ms. 139

Shpëtómë , o i Madh'in'Zot, nga
njeriu i lik; liromë nga burri i
shtrëmbër.

Të çilët mendojnë të kekjie te
zëmbra e 'tire; gjithë ditën men-
dojnë luftime.

E Prêmtia e Madhe ORA E GJASHTETE

Prehiën gluhën e 'tire si ajo e gjalpërit; helm nëpërkash përposh buzëvet t'tire.

Ruajëmë, o i Madh'in'Zot, nga dora e të mëkatruamit; liromë nga njerëzitë e shtrëmbërë.

Atà kërkojën të më përbisiën hapet t'imë.

Madhështorët fsheh rrietët për mua e kurth me tërkuza ndejtën për këmbët t'ime; më vun gurë për në dhrom sa të bie.

U i thash t'in'Zoti: Ti je Perën - dia jim; gjekj, o Zot, zërin e lutjes t'ime.

O Zot, o Zot, fukjia e shëndeties s'ime që më pështrove kriet me hjerë t'ënde te dita e luftës.

E Prêmtia e Madhe ORA e GJASHTETE

Mos më le, o i Madh'in'Zot, të bie te duart e të ligut kundra dishiri mit t'im. Mejtojën kundra meje; mos më lërë mos atà të lëvdonen.

Mbi kriet e atireve që më rrethojën le t'bienjë e kekjia e buzëvet t'tire.

Ka t'bien mbi atà fingjije të ziarmë; ka t'i shtiesh në mjeri sa mos të ngrëhen.

Njeriu me gluhë të ligë mos kjëndroft mbi dheun; të ligat njeriun të kekjë do t'e kjelliën në prishie

Di se in'ZOT ka t'bënjë ligjë të vapëkjëvet; të mjerët ka t'i mbrojnë.

E të drejtitë do t'lartësojën ëmbrin t'ënt e ka t'jesiën përpara fakjies s'ate.

Ms.90 v. f. 42

lêvdi past ... aliluja (3)
lipisi , o Zot...(3) lêvdi past...

Veprime shpëtimin në mes s'Botës
ndëjte duart të dëlira mbi Krikji-
en sa të mbëjidhie gjithë kombet që
thërresien: lêvdi Tij, o i Madh'in'Zot.

nani ...

Posa ngë kemi gudsim... f.45.

st. i d h i o m e l a

Hjos n' S'

O populli jim, që të bëra, thot inë
Zot, a mbi që të helmova? Të verbër-
vet t'atë i dhash dritën, pastrova

E Prëmtia ORA e GJASHTETE

të gërbulët, njeriun shtur te shtra-
ti t'e ngrëjta. O populli jim, që
të kam bër, që më paguan kështu?
Në vend të mannës më jep tameth,
në vend uji më jep uthullë, në vend
të më duash mirë më vë n'krikjë.
Ngë dua më të ju jem pështrimi:
dua thërres kombet e atë ka më lëv-
dojën me Atin e me Shpirtin e U
dua t'i jap atireve gjellën e pa-
sosme.

Hjos n' S'
E më dhanë për të ngrënë
tameth e të pija më dhanë
utullë ms.68

Kori i Apostojvet i thot sot li-
gjëtarëvet e Israelit: o Judhenjë
e farisenjë, vërreni faltoren që
ju prishët, vërreni Kjenkjin që ju
krikjëzuat. E vut te varri, po Ai

E Prêmtia e Madhe ORA e GJASHTETE

me pushtetin e 'tij u ngre. Mos gënjëni; o Judhënjë: isht Ai që ju shpëtoi te dejtja e që ju ushkjeu në shkretirë. Ai isht gjella, Ai drita e pakjia e jetës.

lëvdil ... nanil ...

ηχος υ

Ejani, o popuj Krishtprurësë, le t'shohiëm ç'isht e përbluan Judha tradhëtari me të paligjë të priftra kundra Shelbuesit t'ënë. Sot dënuan të vdisëj FIALEN e Perëndis, të Pavdekshmin; ja dorëzuan Pilatit, dhe e vun n'krikjë te vendi i Kreit.

Tue vuajtur gjithë këto Shelbuesi jinë thërriti tue thënë: Ndëjëji, o Tate, këtë mëkatë: sa t'njohiën kombet ngjallien t'ime së vdekurish.

E Prêmtia e Madhe ORA e GJASHTETE

prokjiëni:

O Zot, i Zoti i jinë, sa i famasëshëm embri jit mbi gjithë dheun!

S u ngjip Madhëria jote mbi kjiell

nga profetsia e Isaïs 52,13-54,2.

Këtë thot in'Zot: shi' se shërbëtori jim ka të ndëlgonjë e ka te jet lartësuar e lëvduar shumë.

SI ka t'çmenden mbi Tij shumë vetë: kështu do t'jet pa lëvdil fitira jote ndër njerëzitë, pa hjë ndër të bijët e njerëzëvet!

Kështu shumë kombe do t'çudhiten e rregjëra ka t'mbilliën gojën e 'tire, pse ata pan atë që atireve ngë kle lajmëruar mbi Atë e ka të ndëlgojën atë që ngë gjegjën.

O i Madh' in'Zot, kush do t'ket besë

ligjëratën t'ënë? E Krahu i t'in'zoti -fukjia- kuj ka t'jet sbëluar?

Na prum lajmin si njëi fëmijë përpara atij, si njëi rrenjie nga njëi dhe i that.

S'ka hje tek Ai, s'ka lëvdi.

E PAM e ngë kishë as hje as bukuri. Të dukurit e 'tij pa nder: si lënë mbë nj'anë nga të bijët e njerëzëvet. Një njeri helmesh e çë njuh hjidhërimin. Na fshehëm skurse fakjiet t'ona nga Ai. Ai kle përbur, ngë e çmuam na. U nglakua me mëkatët t'ona e vuan për ne. Po na e ndëlgua se Ai ishë me kopos, i munduar nga Perëndia e i helmuar.

Ai kle plagosur për mëkatët t'ona; për paligjësit t'ona kle shtipur.

Mundimi i pakjies t'ënë mbi Atë; na klem shëndoshur me purtekatat çë Ai duroi. Të gjithë na jemi si dele të sbjerra, se nga-njeri nesh

u sbuar te dhromi i 'tij.

Perëndia e nglakoi me mëkatët t'ona e Ai, gjith'i munduar, ngë sbilli gojën e 'tij.

Si një dele kjellur për të therrtur e si kjenjë i pa faj përpara atij çë kjeth, i pa-zë; ashtu ngë sbill gojën e 'tij.

Te të përunjurit e 'tij gjikimi i 'tij kle ngrëjtur. E jinin e 'tij kush do t'e rrëfien? Pse kle ngrëjtur nga dheu gjella e 'Tij. Kle kjellur të vdisëj nga paligjësit e popullit t'ij. U ka të jap të likjët për varrëzimin e 'Tij e të kjosmitë për vdekjen e 'tij.

Se Ai ngë bë paligjësi; ngë ugjet gënjim te goja e 'tij e Perëndia ka t'e pastronjë nga plagët. Në ju falni ndo dhuretë për mëkatët t'uaja, shpirti i jij ka t'shohënjë fakjien e ditëve të glata.

E ka të det in'Zot të i ndsierënjë dhëmbien e shpirtit t'tij e t'i dëftonjë atij dritë e ka t'i gjeshënjë me ndëlgim.

Ka t'njohënjë drejtërin e të drejtit se shërbeu mirë shumë vetë e mëkatët e 'tira ka t'i marrënjë në krahë Ai.

Prandaj ka t'ket për trazhgim shumë vetë; me të fortitë ka t'ndanjë plaçkat, përçë për atë gjella e 'tij kle dhënë vdekjies.

E u nëmërua ndër të paligjët e Ai kjelli n'krahë mëkatët e shumë vetëve e kle dhënë për mëkatët e 'tira.

Gëzou, o shterpë, që ngë lind. Këndo e ngre lart zërin t'ënt, ti që ngë dhëmbe: pse më shumë janë bijët e shterpës se të t'martuames.

nga litra e Sh.Palit

EBRENJEVET

II, 11 - 18

Vëllezër, Ai që shejtëron e të shejtëruamitë janë gjithë nga Një.

Prandaj ngë ka turp t'i thërresënjë vëllezër tue thënë: dua të lajmëronj embrin t'ënt vëllezërvet t'imë, dua t't'lëvdonj në mes s'mbledhies. E përsëri: u do t'kem besim tek Ai. E prapë: këtù jam u e bijët që in'Zot më dha. Posa andai bijët kanë pjesë te gjaku e te mishët, gjithëashtù edhe Ai ka pjesë me atë.

Sa paj të vdekjies të prishëj atë që kishë zotërin e morties v.m.th. DIALLIN Debetëllirënjë gjithë atë që për dre të vdekjies ishën si në robëri.

Vërtetani Ai ngë vien të ndihënjë Engjëjitë
po farën e Adhamit. Shi' përçë i
ngisëj t'i glisëj te gjithkjish vë-
llëzërvet : sa të bënej te shërbesa
e t'in'Zoti, një krieprift lipisjar
e besnik, i zot të shpaguej mëkatët
e popullit. Pse kështû, tue duruar
ngarie e vuajtje, mënd't'ndihëj ata
çë janë ngar.

Vangjeji

Lk.23,32-49

v.f. 217

Le mëshirët t'ote.f.52

kondakjion: Ejani të këndojëm...

f.134.

lipisi, o Zot (40)

O Zoti Krisht Perëndi... f. 20

Lipisi, o Zot (3) Tij më të ndero-
shme ... f.21

mbë embrin e t'in'Zoti bekona o
AT

I Madh'in'Zot na mëshiroft e na
bekoft e na dëftoft fakjien e 'tij
e paçit lipisi për ne.

O Perëndi e Zoti i fukjivet...f.53

*

ORA e NENDETE

e TE PRENPTIES s'NADHE

Bekuar kloft ...

Lëvdi Tij...Rregji i kjielliës
çë na përgëzon ...

Trisajon Se jotia isht rregjë-
ria ...

Ejani t'i falemi ...

Ms.68

Shpëtomë,o i Madh'in'Zot,përcë
ujërat m'arrëjën te shpirti.

Vajt'e sosa te pajta të thella
e ngë kam ku të mbahem. Arrura në
fund të ujit e rriedhiat më rrna-
riën.

U kam lodhur tue uluritur;grika
jime u ngjurr;syt t'imë u sëmurën

E Prëptia e Madhe ORA e NENDETE

tue pritur Perëndin t'im.

U shumësuan më se kripët e kreit
t'im atà çë më mbajën mbëri dhurat.

U kanë mfortësuar armikjët t'imë
çë më përzën pa pasur likjë;pata
të priria prapa atë çë ngë vodha .

O Perëndi,Ti njeh lënësin t'ime
e mëkatët t'ime ngë të janë fshe-
hur.

Mos paçin të ngukjen për mua atà
çë shpresojën tek Ti,o Zot i fukji-
vet.

Mos patshin turp për mua atà
çë të kërkojën,o Zot i Israelit.

PSE për Tij u kam vuajtur shumë.
E TURPI KA pështiellë fakjen t'ime.

U bëra i huaj t'imë vëllëzërve; i
huaj të bijëvet e mëmës s'ime.

E Prëptia e Madhe ORA e NENDETE

Zeli i shpis t'ënde më gris e të
sharat e atireve që Të shajën Tij
bien mbi mua .

Kam munduar shpirtin t'im me ar-
gjërime,po këtë u pruarën për dhu-
në mbi mua .

Vura sipër meje një thes e u bë-
ra pullaria e gjithëve.

Ata që rrin ujurë te diert më fla-
siën kundra e atà që dëhen këndojën
kënka mbi krahët t'imë.

Po u tue parkalesur u prora tek
Ti;kloft ki kjëroi që më pret mirë.

Për sa e madhe isht lipisia jote,gjegjë-
më,o i Madh'in'Zot,tek e vërteta e
shpëtimit t'ënt.

Shpëtomë nga bajta mos të kjëndro-
një i ngiitur;liromë nga ata që më

E Prëptia e Madhe ORA e NENDETE

mbajën mbëri e nga të humbëtitë
e ujëravet.

Mos më pështrofshit stuhla e ujë-
ravet; mos më gjëllitshintë hum-
bëtitë;putsi mos më mbillëshit gojën
e 'tij mbi mua.

Gjegjëmë,o i Madh'in'Zot,se e ëm-
bël ë lipisia jote;për sa të shuma
janë mëshirët t'ote prir siun mbi
mua.

Mos prir fakjien t'ënde prej meje
bir i jit, se jam në helm; njizegje-
gjëmë.

Kij kujdes për shpirtin t'im r liroje;
nga armikjët t'imë liromë.

Ti e njeh të sharit t'im,turpin
t'im,dhunën t'ime.

Përposh syvet t'atë janë atà që
më shtrengojnë. Shpirti jim ngë pret
më se të shara e mjeri.

Prita kush të ndaj me mua lipin

t'im e ngë u ndoth njeri; kë të më ngushëlloj e ngë e gjeta.

E më dhanë për të ngrënë tamëth e të pija më dhanë uthullë.

Kloft triesa e 'tire kurth për ata e për mundim e skëndall.

E u errëshin syt e 'tire mos të shohiën e kurrisi i 'tire u kurrufshit më shumë.

Derth mbi atë mbërin t'ënde e zëmërimi jit i rrëmbefshit.

U bëft e shkretë ndenja e 'tire e te tendat e 'tire mosnjeri i rrishit më.

Përçë atë që Ti kësitate ata e kanë përçënë e mbi dhëmbien e plagavet t'ime kanë shtuar edhë.

Lei të shtojën paligjësi mbi paligjësi e mos i le të hijën te drejtësia jote .

Le t'jen shliejtur nga libri i të gjallëvet e mos klofshin shkruar me të drejtitë.

U jam i vapëk e me dhëmbie. Shpëtimi jit më ka mbajtur mua.

Do t'lëvdonj embrin e t'in'Zoti me kënkë: do t'e madheronj tue e e kënduar.

Shërbes që do t'i pëlqenjë më shumë se viçi i ri ç'isht e ndsier bri e thonje.

Le t'shohiën të vapëkjit e t'bëjën harë; kërkoni Perëndin e do t'rronjë shpirti i jij.

E Prêmtia e Madhe ORA e NENDETE

Se i gjegji të mjerët in'Zot, e të burgosuritë ngë i harron.

E lëvdofshin kjielliat e dheu e dejti e çëdo lëvizet tek ai.

Pse Perëndia ka t'shpëtonjë Sio - nin e kjitetet e Judhës ka t'stisen.

E ka të jesiën tek ajo e ka t'e ken për trazhëm.

E fara e shërbëtorëvet t'atë do t'e ken e atà çë duan mirë emërin t'ënt ka t'i rrin .

Ms.69

O i Madh'in'Zot ver're të më ndihësh; anangasu të më ndihësh, o i Madh'in'Zot.

E Prêmtia e Madhe ORA e NENDETE

U turpërofshin e u dhunofshin atà çë kërkojnë gjellen t'ime.

Atà çë më duan të kekjë u pruarshin prapa e u trazofshin.

Pa mënuar le t'ven prapa me dhunë atà çë ven tue thënë: ai, ai.

U gëzofshin e paçin harë tek Ti atà çë Të kërkojnë, o Perëndi, e atà çë duan shpëtimin t'ënt le të then kurdoherë: u madhëroft i Madh'inë Zot!

U jam i vapëk e i mjerë; ndihëmë, o Perëndi.

Ndihma e shpëtimi jim je Ti, mos mëno, o i Madh'in'ZOT.

Ms. 85 v.f.58 .

lëvdi past... ALILUJA (3)
lipisi, o Zot... (3) lëvdi past...

Si pa Gjellëdhënësin vjerrë te
Krikjia kusari tha: në ngë ishë
Perëndia i mishëruar Ai që ë vënë
n'krikjë me ne, dielli ngë kishë
fshehur rrezet e 'tij, dheu i sko-
tist ngë u kishë shkundur!

Ti që gjithkujsh duron, o i Madhi
in'Zot, kujtomë te rregjëria jote!

nani ... O Ti që për ne... f. 61.

st. i d h i o m e l a

pyqos

Çë tmerr me pa Kriuesin i kjiellit
e të dheut vjerë të Krikjia. Diel-
lin të errësuar e ditën bër natë e
dheun të shtienjë kurmet e të vde-
kurëvet. ^{jashta varrevet} Bashkë me atë të proskji-
nisiëm, o Krisht, shëlbona.

Ndajtën pethkat t'ime ndër'ta
e mbi rrobiku shtun shortën.ms.21.

4x03 → B

Kur të paligjëtozhduan te krikjia
të Zotin i lëvdës, Ai i tha atireve:
tekù ju helmova? tekù ju zëmërova?
Më para se U kush ju liroi nga sh -
trëngesat? E nani si më shpaguani?
për të mirat që ju bëra më jipëni
të kekjia, në vend të mjekughavet më
grëmuat një varrë, në vend të mannës
më dhat tamëthin, në vend të ujit më,
dhat uthullën.

Andai do thërres kombet e atë do
t'më lëvdojën bashkë me Atin e me
Shpirtin Shejt.

lëvdi... nani ...

E Prêmtia e Madhe ORA e NENDETE

Viret sot mbi një dru
Ai që ndë ujëra dheun vori.

Kurorë glëmbash i vun rreth
kreit Mbretit t'Engjëjvet.

Një tsopë të kukje për të
kjeshur i vun mbi krahët Atij
që vesh kjiellin me mjekulla.

Shplaka duroi të kishë
Ai që liroi Adhamin në Jordhan.

Me gozhda kle vierrë
Dhëndërri i Klishës.

Me shtizën kle i lavosur
i Biri i Virgjëreshës.

Na i falemi Pesimevet t'atë,
o Krisht !

Dëftona të ngjallurit t'atë
të lëvqoshmit.

E Prêmtia e Madhe ORA e NENDETE

prokjiunenon

Ms.13 Tha i lëni te zëm-
bra e 'tij:s'ka perëndi.

S'ka njeri që bën të mi-
rën; as një.

nga Profetsia e Jeremls

XI,18-23;XII,1-5;9-11;14-15.

O i Madh'in'Zot , njoftomë e
do t'dsë. Ahierna dsura u mendimet
e 'tire. Si kjenkjë që ë kjellur t'
jet thertur ngë dija gjë. Për mua
atà mëdojën një shestim të lik
tue thënë:presiëm këtë dru si bën
pemë,shrrenjosmie nga jeta e të gja-
llëvet.Embri i 'tij ngë do t'jet
kujtuar më.

Po Ti,o i Madh'in'Zot që gjikon
drejt , që vëzhgon veshiat dhe zë-

mërat bëjmë të të shoh të shpagu-
hesh mbi atà, përcë Tij u të trua-
ta gjykjin t'im.

Prandaj burravet e Anathotit që
më kërkojën gjellën e që thonë mos
profetizosh më ëmbrin e t'in'Zoti;
në ngë na gjegje ka t'jesh vrar nga
duart t'ona", in'Zot tha: U do t'i
godit, djelmte ka vdesiën me shtatën, të bi-
jët e të bijat ka vdesiën uriet.

Për atà mosgjë lipisi kur u të
mundonj burrat e Anathotit te viti
i ndeshkimit t'tire.

Ti je shum'idrejt për mua sa u të
mbronem përpara Teje, po mbi gjithë
u marr leje e kudsonj t't'bënj një
piejtie: përcë dhromet e të palutsh-
mëvet janë të plotë me lule? Si ë
që përparojën atà që shtipiën ligjën?

Ti i mbeltove e ata shtun rrenjat,
patën bij e bën pemë; po Ti je nd'a-
nëzë gojës s'tire, po lark nga zëmbrë.

Ti mua më njeh, o i Madh'in'Zot,
më vëzhgove zëmbrën dhe e sheh se
ë me Tij. Ata pastroi te dita e
theries. Njera kur ka t'mbanjë lip
jeta e çëdò bar të kopshtit ka
thahet për këkjin e atireve që i
banojën?

U sdukën kafsha edhe zoga pëzrçë
ata thanë: ngë sheh in'Zot udhët t'
ona. Këmbët t'ote rriedhiën e të li-
rojën. Mbëjidhij ju gjithë bishëra
të egër, ejani e hani. Shumë delmerë
kanë prishur vreshtën t'ime, kanë
shtipur dheun t'im, shtërruar peth-
kun t'im akjë të dishiruar në sh-
kretirë të pashkuarshme.

Se kështu flet in'Zot: mbi gjithë
këtë gjitonët të likjë duan të za-
ptojën trazhginin që u dhurova Isra-
elit. Shi' se U atà ka t'i shkul nga
dherat e 'tire e në mes s'tire ka

'lironj Shpin e Judhës e ka t'streksënjë pra se pas çë i përzura do t'priren e U ka t'i vendos çënjerin te trzhgimi i 'tij,çënjërin te dheu i 'tij.

nga litre e shën Palit

EBRENJEVE

X, 19-31

Andai tue pasur, o vëllezër, gudsim të hijëm te shejtoria paj të gjakut e Iisuit nëpër dhromin i ri dhe i gjallë çë sbilli Ai për ne nëpër villin d.m.th. nëpër mishët t' 'Tij; tue pasur një Prift i mathë te shpia e Perëndis, kjasemi me zëmërë e thjeshtë, e plotë me besë tue kjëruar zëmërat nga një ndëgjegje e kekjie e tue lajtur kurmin me ujë të kulluam e tue mbajtur të patundshëm rrëfimin e besës. Besnik isht Ai çë taksii!

Ruhemi njeri me t'jetrin sa t'jemi

shtijtur te dashuria e te të bëmat e mira.

Mos lëm mbledhiet si tsa vetë kanë zakonë e bëjëm zëmërë njeri t'jetrit, edhe më shumë se shohiëm se kjaset dita. Në na pas të njohurit të vërtetën, vazhdojëm me-hir të mëkatrojëm, atëherë ngë ka më flijë lënë për mëkatët e ka t'jet një të tmerëshëm të pritur gjikimin e një flakë ziarri çë do të tretënjë atë çë janë kundra.

Në nje shkel Ligjën e Moiseut përpara dy a tre deshmëtarë, ë vrar.

Sa më shumë mundim ju duket se do t'hekjënjë ai çë ka shkelur me këmbë të Birin e Perëndis e çë ka menduar se Gjaku i dhiatës, tek i çili u shejtërua, isht si gjithë t'jerët edhe ka shajtur shpirtin e dhuratës;

Pse e dim atë çë Ai tha: U vet dua të gjikonj, U ka t'shpaguanj, thot

in'Zot. Edhë përsëri: In'Zot gjikon
popullin i 'tij".

**Purë e tmerrshme të biem te duart
e Perëndis gjallë!**

Vangjeji Ja.XIX,23-37

v.f. 220.

Paj t'embrit t'ënt
të shejt... v.f.67

Trisajon Se jotia isht rr...

kondakjion: Ejjani të këndojëm
f.134.

lipisi, o Zot(40)

O zoti Krisht Perëndi ... f.20

lipisi, o Zot (3) lëvdi past.

Tij më të nderoshme ... f.21

mbë embrin e t'in'Zoti bekona o
ZOT.

I Madh'in'Zot na mëshiroft e na
bekoft e na dëftoft fakjien e
'Tij e paçit lipisi për ne .

O ZOT e i ZOT Iisù KRISHT,
Perëndia jinë...v.f. 68 .

Lëvdi Tij, o Perëndia jinë,
shpresa e gjithë neve, paçë
lëvdi !

Zoti Krisht, i vërteti Perëndia
jinë, që për shëndetën e jetës du-
roi pështimata, purtëkata, shpla-
ka, krikjie, vdekjie ,
paj të Povirgjërës e shën Mëri
Mëma e 'Tij e pa j të gjithë
Shejtravet na bekoft e me li-
pisi na ruashit si i mirëth e
njeridashës.

VANGJEJET

TË OREVE TË MËDHA

në

KRISHTLINDJE , THEOFANI'

e tek e PRËMPTIA E MADHE

K R I S H T L I N D J A

tek E PARA ORE

Mt. I, 18-25

Të lerit e Iisù Krishtit
kle kështu: Martuarë që kle e Jë-
ma e 'Tij, Mëria, me Jozefin, më pa-
ra se të përziheshën, u gjënd se
kishë zënë në gji paj të Shpirtit
Shejt.

E Jozefi burri i 'Saj, se ishë i
drejt, e ngë dej t'e vëj për në
gojë, dej më mirë t'e lëj fshehur
fshehur.

E këtë shërbise i shkojën atij
te kriet, kur, shi', te nëndërra një
ëngjell i t'in'Zoti ju dëftua tue
thënë: Jozef, bir i Davidhit, mos
trëmbesh të marrësh me tij Mërin
gruan t'ënde, pse qëdò u bë tek a-

Krishtlindja V. i të parës Orë
+++++
jò, isht nga Shpirti i Shejt.

Ka t'i lehet një Bir e ti ka t'e
thresësh embrin e 'tij Iisù, pse
Ai ka t'shpëtonjë popullin e
'tij nga mëkatët e 'tire.

E këtë të gjitha kanë strek-
sur sa t'mbaronet e thëna e
t'in'Zoti me gojën e Profe-
tit që thot: Shi' Virgjëre -
sha se ka të zënjë në gji e
ka t'i lehet një Bir e ka t'
i vën embrin e 'Tij E m a -
n u i l që këthier vien më
rar: P e r ë n d i a me ne,

E si u sgjua Jozefi nga gju-
mi bë ashtu si i urdhuroi atij ën-
gjëlli i t'in'Zoti, e mori me 'të
gruan e 'tij.

E ngë e njihëj njera që i leu Bi-
ri i 'Saj i pari e e thërriti em-
brin e 'TIJ I i s ù .

tek E TRETA ORE

Lk. II, 1-20

Tek atò ditë dolli një urdhër nga Kjesar Augusti sa t'shkruheshën gjithë jeta.

Këta të shkruar kle të parët bër kur i Dërguam të kjëvarrisëj Sirin ishë Kuirini.

E vejën të gjithë të shkruheshën nga-një te kjiteti i 'tij.

Andai u hip edhë Jozefi nga Gali - lëa, nga kjiteti i Nazarëtis te Judhea, te kjiteti i Davidhit të çilit i thonë Betlemi, pse ishë ai nga shpia e atë-ria e Davidhit, sa t'shkruhej bashkë me Mërin, çë kishë marrë për grua, e çila ishë e sëmurë me barrë.

Krishtlindja V. i të tretës orë

E kle , se si atà ishën atjè jerdhën ditët e 'Saj të lindëj.
E lindi të Birin e 'Saj të Parin, dhe e pështolli me skutinat e e vu ri te grazhdi: porsanith për atà ngë ishë vend te bujtoria.

E tek ata vende ishën delmerë çë rrijën jashta natën tue ruajtur be rrat e 'tire. E shi' një Engjëll i t'in'Zoti ju dëftua atireve, e lëv dia e t'in'Zoti shkëlkujeu rreth a tireve: e u trëmbën fort me një dr të madhe.

E Engjëlli i tha atireve: mos trë bij: shi' se u le për ju sot **Shpëtu si** , çë ë **Krishti Zot** te kjiteti i Davidhit. E për ju ki ë shengu: ka t'gjeni një të vogëlth pështiellë te skutina, vënë te grazhdi.

E njëiherie u ndoth me ëngjëllin një lusmë të ushtris s'kjielliës çë lëvdojën Perëndin e thëshëjën:

Krishtlindja V. i të trtës orë

Lëvdi Perëndis te më i larti
kjiell, pakjie mbi dhe, ndër një
njerëzit mirëdashie !

E të klënit që ëngjëjit nga ata
muarn'e vanë te kjiellia, atë njerë-
zë delmerë zun të thoshëjën ndër
'ta: le t'vemi njera Betleëm sa të
shohiëm atë që kle e që in'Zot na
bë të njihëm.

E jerdhën me vrapë e gjetën Mërin
e Jozefin e të vogëlin vënë te gra-
zhdhi.

E si e pan zun të ndëlgojën atë që
ju kishë thënë atireve mbi këtë Di-
alëth.

E gjithë famaseshën të gjegjurit
këto të fola nga delmerët.

E Mëria gjithë këto shërbise i
ngrëj brënda në vetëhë tue menduar
te zëmbra e 'Saj.

K r i s h t l i n d j a

E u këthien delmerët tue lëvduar
e tue kënduar Perëndin mbi gjithë
atë që kishën gjegjur e kishën par
ashtu si ju kishë folë atireve.

tek E GJASHTËTA ORË

Mt. II, 1-13

Posa leu Isuthi në Betleëm
të Judhës, te ditët e Erodhit rre-
kjë, shi' se Magjijnjë arrûn në Je-
rusalim nga del dielli, tue thënë:
ku isht rregji i Judhenjëvet që
u le ? se na pam yllin e 'Tij te-
kû del dielli e jerdhëm t'i fale-
mi.

E si e dsuri Erodhi rrekjë u
tërbua e bashkë me atë gjithë Je-
rusalimi.

E mbëjodhi gjithë të Parët e pri-

Krishtlindja V. i të gjashtëtës Orë

|+++++|

ftravet edhe shkruesit e popullit e i piejti atireve ku ki't'lehej Krishti.

Ata i thanë: në Betleëm të Judhës; pse kështu kle shkruar nga Profeti: **E Ti Betleëm, dhe i Judhës, ngë je Ti, jo më e vogëla ndër zotërit e Judhës, pse ngah Ti ka të dalnjë Kaptanja që ka t'kulotnjë popullin t'im Israhelin.**

Ahierna Erodhi fshehurith thriti mbë nj'anë Magjinjtë e kërkoi të dsëj mirë kjëroin kur ju duk ylli.

E i dërgoi në Betleëm e i tha: ëtsëni e kërkoni mirë e pjeni me kujdes për Dialëthin; e posa që kini gjetur, m'e dërgoni të thënë sa edhe u të vinjë t'i falem.

E atë kur gjegjën rregjin u nisën e vanë. E shi' ylli, që kishën par ku del dielli i vej përpara njera që jerdhi e u mba atjè sipër ku ishi Dialëthi.

Krishtlindja V. i të gjashtëtës ORE

+++++

E atë kur pan yllin, u gëzuan me harë të madhe shumë, e si jerdhën tek ajo shpi, gjetën Dialëthin me Mërin, të Jëmën e Tij e tue rar përmist ju falën e sbillën thesaret e 'tire e i dhanë dhuratë, ar, livan e mirrë.

E si patën kujtuar te nëndërra të mos prireshën te Erodhi, u mbëjodhën te dherat e 'tire për një dhrom t'jatër.

tek E NËNDËTA ORE

Mt. II, 13-23

Posa që u nisën Magjinjtë, shi' një Engjëll i t'in'Zoti i dëftonet te nëndërra Jozefit tue thënë: ngreu, mirr Dialin e Mëmën e 'Tij e jik në Egjipt e rri atjè njera kur t'e thom u. Se Erodhi isht e kërkon Dialin sa t'e vrasënjë.

Krishtlindja V. i nëndetës ORE

+++++

E ai ,të ngrëjturit,mori që natën bashkë me 'të Dialin e të Jëmën e 'Tij e vate në Egjipt.

E rrijti atjè njera kur vdikjë E-rodhi:sa t'mbaronej e thëna nga in' Zot në gojë të profetit që thot:
Nga Egjipti U thërrita Birin t'im .

Ahierna Erodhi,si u pa gënji-er nga Magjinjtë,u ngroh shumë,e dërgoi e vrau gjithë djelm-të,çë ishën Betleëm e rreth te gjithë anët e vendet e 'saj,di vjetsh e aposhta,mbi kjëroin çë e dsu-ri nga Magjinjtë.

U mbarua atë herë e thëna e Jere-mis Profet që thot: U ndie një zë në Ramë,një thirmë e madhe,të klar e dënesë: Rahjilia klaj të bijët e 'saj e ngë dej t'ishë ngushëlluar,pse atà ngë janë më.

Krishtlindja V.i të nëndetës Ore

+++++

Kur pra vdikjë Erodhi,shi' një ën-gjëll i t'in'Zoti i dëftonet te ën-dër-ra Jozefit në Egjipt,tue thënë: ngreu,mirr bashkë Dialin e të jëmën e 'Tij e jets në dhe t'Israelit.

Por si gjegji se Arkelau rregjëroj mbi Judhën në vend të t'jatit,t'E-rodhit,u trmp të vej atjè. E si pa-ti thënë te nëndër-ra,vate te anët e Galilës.

E,të jardhurit,u mbëjoth te një kjitet çë i thonë **Nazaret**: sa të mbaronej e thëna në gojë të profettravet:**se ka t'jet thirrë**

N A Z A R E N .

T H E O F A N I A

tek

E P A R A O R E

Mt. III, 1-6

Tek ai kjêrò Jan Pagêzori erdhi në shkretirë të Judhës tue ligjëruar e tue thënë: **vëni tru, pendonij: se ë nd'anëzë rregjëia e kji-elliavet.**

Ki isht Ai mbi Kë foli Isaia Profet kur thot: **një zë që thërret në shkretirë: dërtoni udhët e t'in'Zoti, ndrekjëni dhromet e 'tij.**

E Jani kishë të veshurën kjimesh gamili e një rreth likurie te mesi i 'tij: e të ngrënët e 'tij ishën karkaletsë e mjajtë të egër.

Ahierna dilëj të vej tek Ai Jerusalimi e gjithë Judhea e gjithë atò përjashta nd'anë t'Jordhanit.

Theofania V. i të parës orë

+++++

E ishën pagëzuar nga Ai te Jordhani, tue skomollisur mëkatët e 'tire.

tek E T R E T A O R E

Mk. I, 1-8

Të zënit fill të Vangjejit e Iisù Krishtit, t'Birit t'Perëndis, ashtù si isht shkruar te Profetrat: " Shi' se u dërgonj ëngjëllin t'im përpara fakjies s'ate, atë që ka të dërtonjë udhën t'ënde përpara Tij.

Zëri i njëi që ulurin ndë shkretirë: bëni gati udhën e t'in'Zoti, ndrekjëni dhromet e 'tij.

U ndoth Jani tue pagëzuar te shkretira e tue leçitur pagëzimin pende - sie për ndëjësë të mëkatëvet.

E nga atà dhera tek Ai vejën gjithë

Judhea e Jerosolimitrat e të gjithë ishën pagëzuarnga Ai te lumi i Jordhanit tue skomollisur mëkatët e 'tire.

E Jani ishë veshur me kjime gamili e te mesi i 'tij kishë një rreth likurie e haj karkaletsë e miajtë të egër.

E ligjëroj tue thënë:"Isht e vien pas meje një më i fort se u. Atij u ngë jam i mirë t'i sglith përmist rripet e këputsëvet e 'Tij.

U ju pagëzova ndë ujë;por Ai ka të ju pagëzonjë juve ndë Shpirt të Shejt.

tek

E NËNDËTA ORE

Lk. III,1-18

Tek i pesëmbëdhietëti vit i mbretërimit të Tiber Kjesarit, kur Pontsië Pilati kjivarrisëj Judhën e ishë tetrarhë Erodhi i Galilës, Filipi, i vëllai i 'tij i Iturisë e Trahonisë e Lisania i Avilinis e ishën kriepрифtra Anna e Kajafa, filala e t'in'Zoti u pruar te Jani, i biri i Zaharis, në shkretirë.

E ai jerdhi te gjithë anët e Jordhanit tue ligjëruar pagëzim pendesie për ndëjesë të mëkatëvet si ë shkruar te libri i të thënavet e Profetit Isai që thot: Zëri i atij që thërret në shkretirë tue thënë: bëni gati udhën e t'in'Zoti, bëni

Theofania Vangjeji i të IX ORE

të drejtë dhromet e 'tij.

Nga hon do t' mbëlonet e nga mal e kodrë ka t'jen ujur e dhromet të shtrëmbërë ka të ndrekjen e të ashpëritë ka të bënen fushë, e nga njeri do t' shohënjë shpëtimin e t'in'Zoti.

Atire gjindeve pra që vejen e pagëzone-shën tek ai i thëshëj: të lerë në - përkash, kush ju bindi të jikëjët nga mbëria që po vjen?

Bëni nanë pemë pendesie e mos zëni fill të thoni në vetëhë t' uaj: kemi për at Abraamin: u ju thom ju v e se Perëndia nga këta gurë mëndë të ngrënjë bij Abraamit.

Dha sopata ndodhet mbi rrenjë të drunjëvet: nga dru që ngë bën pemë të mirë ka t'jet prer e shtur të ziarri.

E gjindia i piejën tue thënë: kush ka di të veshura, le t' japënjë njerëni kuj ngë ka. Edhë ashtu bëfshit

Theofania Vangjeji i të IX O

ai që ka të ngrënera.

Jerdhën edhë voishtarët të pagëzoneshën tek ai e i thanë: Mësues, që ka t' bëjëm?

E ai i tha: mos mirrëni më shumë se sa kini urdhuruar.

I piejën edhë ushtarët tue thënë: e na që ka t' bëjëm? E ai i thëshëj atireve: mos shtrëngoni tepër njeri e mos ngalesni me të rreme e kënakjij me rrogët t' uaja.

E si gjindia prisëj e të gjithë llojasiën te zëmbat e 'tira mbi Janin, në Ai ishë thomse Krishti, ju përgjekjë gjithëve Jani tue thënë: u ju pagëzonj me ujë, po isht e vien Një më i fort se u, të çilit ngë jam i mirë t' i sglith rripet e këputsëvet.

Ai ka t' ju pagëzonj në Shpirt të Shejt e ziarri.

Te dora e 'tij isht lopata e Ai

Theofania Vangjeji i të IX ORE

do t'kjëronjë lëmin e 'tij e do t'
mbëjdhënjë drithët te drithrikjet
e 'tij e kashtën ka t'e djegënjë me
ziarr të pashuashëm.

E tue mësuar disa t'jera, li-
gjëroj popullit novën e mirë.

E PRËMPTIA E MADHE

tek

E PARA ORE

Mt. XXVII, 1-56

Tek ai kjërò mbajtën këshill gji-
thë kriepriftrat edhe Plekjtë e
popullit kundra Iisuit sa t'e vri-
siën.

E lidhur e kjellën dhe e lanë te
duart e Pontsië Pilatit kjiverta -
rit.

Kur Judha pa se Iisui kle gjiku-
ar për mortë, u pendua, e mori tri -
dhietit dënarë të 'rrgjëndë e ja
propri kriepriftravet edhe Plekjë-
vet tue thënë: U mëkatrova, se ju
dhash te duart Gjak të pafajshëm.
Por atà i thanë: çë e duam na? Ti
ka t' vërresh!

E ai shturi atjè te faltoria të 'rrgjëndit e jiku e vate u vuar e u mbit.

Kriepriftrat pra muartin ata dënarë të 'rrgjëndë e thanë:ng'isht drejt se këta t'i vum te thesari i Faltores,se janë çmim gjaku.

E atà mbajtën këshill e blen me atà dënarë dheun e shtëmbarit për të varrzuar të huajit.

Prandai kle thritur ai dhe dhe gjaku'njera më nanl.

Ahierna u mbarua e thëna e profetit Jeremi,çë thot:"E muartin tridhietit dënarë të'rrgjëndë ,çmimin e të çmuamit,të Atij çë kle çmuar nga të bijët e Israelit, e ja dhanë të blijën dheun e atij çë bën kjeramidhe - e shtëmbarit- ashtu si më kishë urdhruar in'Zot. "

E Isuthi u ndoth përpara Kreut e vendit e Kreu i piejti tue thënë: Ti je rregji i Judhenjëvet ?

E Isuthi i tha atij: ti vet je e thua.

E kur e ngalesiën të Parët e priftravet edhe Plekjtë,Ai ngë përgje - gjej gjë fare.

Ahierna i thot Atij Pilati:ngë gje gje Ti sa të deshmojën kundra ?

E atij ngë ju përgjekjë te mosnjera fialë akjë se i Pari famasej fërt.

Për ditën e festës kishë zakonë Kreu i vendit t'i lëshoj gjindes një i lidhur,kë dejën atà.

E kishën ahierna një të lidhur të njohur,çë i thoshiën Baraba.

E kur atà ishën atjè bashkë mbëjedhurë,Pilati i tha atireve:kë doni t'ju lishonj ? Barabën a Iisuin çë thoni Krisht ? SE E DIJ SE JA kishen dhënë te duart për smir.

E Prëmptia e M. Vangjeji i të I O
†.....

E si rrij ujur mbi thronin e Ligjës, i dërgoi thënë gruaja e 'tij: mosgjë të kesh ti me atë të drejt, se sot për atë u reva shumë te ëndërra.

E të Parët e priftravet e plekjtë shtijtën gjindet të lipiën Barabën e Iisuin t'e vrisiën.

U përgjekjë pra Pilati e i tha atireve: çilin doni ju të ju lë nga të dy? E atë thanë: Barabën; I thot atireve Pilati: e çë ka t' e bën Iisuin çë thonë Krisht? I thonë atij të gjithë: le t've n'krikjë!

I thot atireve kjierrtari: se çë të kekjë ka bër Ai? E atë më shumë po ulurijën tue thënë: le t've n'krikjë.

E të parit Pilati, se ng'e ndihëj e se po bënej trazim, mori tsa ujë e lajti duart përpara gjindes tue thënë: u jam pa faj te gjaku i këtij të drejti: ka t'e vërreni ju.

E Prëmptia e M. V. i të parës Orë

E gjithë populli u përgjekjë e i tha: gjaku i 'tij mbi ne e mbi bijtë t'anë.

Ahierna i lishoi atireve Barabën e Iisuin, posa çë e bë t'e dërsëllojën, ja dha te duart sa t'ishë vënë n'krikjë.

Ahierna ushtarët e kjivertarit, si e muarën Iisuin dhe e prun te pretorii, u mbëjodhën gjithë shokët nd'anëzë Atij. E posa e dçeshën, i vun n'krahë një mëndil të kukjë, e pleksur një kurorë glëmbash, ja vun mbi krie e një kallëm te dora e drejtë e 'tija. E tue përglunjur përpara Atij, e shajën tue thënë: Të falemi, o Rrekjë i Judhenjëvet!

E tue pushtijtur mbi Atë, i mirriën kallmin e ja kërsisiën te kriet.

E posa çë e patën kjeshuar, i ndsuarën atë mëndil, e veshën me të veshurat e 'tija dhe e kjellën t'e vëjën

n'krikjë.

E si ish'e diliën gjetën një njeri Kjirinë, për emër Simon: këte e shtrënguan të nglakoj krikjien e 'tij.

E të jardhurit te vendi që i thonë Golgothà—që vien më rar vend krei—i dhanë Iisuit të pij uthullë të përzieme me tamelth: e si Ai e ngjepsi, ngë deshi t'e pij.

Posa pran e vun n'krikjë, atà ndaj-tën pethkat e 'tij tue shtur shortën, sa t'mbaronej e thëna e profetit **ndajtën të veshurat t'ime ndër 'ta e mbi rrobikun t'im shtunshortën.**

.E u ujën atà e atjè rrijën dhe e ruajën.

E i vun sipër kriet e 'tij shkruAR fajin e 'tij: **Ki isht Iisui Rregj i Judhenjëvet.**

Ahierna atà bashkë me Atë vun n'krikjë dy kusarë, një tek e drejta e një tek e shtrëmbëra.

E atà që shkojën e nëmiën tue tundur kriet e tue thënë:

Ti që gorromis faltoren e te tri ditë e stis;shpëtò tij vet.Në je Bir i Perëndis,sdripu nga krikjia.

Gjithënjë edhë kriepriftrat, tue kjeshuar bashkë me shkruesit e me Plekjtë thoshiën: T'jerë Ai i shpëtoi, vetëhën ngë mëndë t'e shpëtonjë.

Në isht rrekjë i Israelit, le t'scripet nanì nga krikjia e E kemi besë.

Ai vu shpresë te Perëndia, le t'E lironjë, në e do: se tha: **se jam Bir Perëndie.**

Ashtù edhë kusarët që ishën bashkë me Atë në krikjë, e shkarzejën.

Që tek e gjashtëta orë njera tek e nëndeta u bë më t'errët mbi gjithë jetën.

E mbë të nëndëtën orë Iisui shtu një thirmë të madhe tue thënë:

Ili, Ili, lamà savahtani, që vien më

E Prëmtia e M. V. i të PARES ORE

+++++

rar: Perëndia jim, Perëndia jim, përsë
më le ?

E tsa vetë nga atà që ishën atjè, si
e gjegjën, thoshëjën: se ki thretElin.

E shpejt tue rriedhur një nga atà,
të marrit një shpuzë, e njomi te uthu-
lla , e vu mbi një kallëm e ja jipëj
t'e pij.

E të t'jerët thoshëjën: le t'jesë;
shohiëm në vien Elia t'e shpëtonjë.

E Iisui pameta me zë të mathë tue
thirrë dha shpirtin.

E shi' villi i faitores u shkjuar
'n dysh; që lart njera posht, e dheu
u tund e gurët plasën: E VARRET U
sbillën e disa kurme shejtrash që
kishën vdekur u ngjallën.

E të dalë nga varret, posa që u ngjall
Iisui, atà hijtën te hora e shejte e
ju dëftuan disave.

E kjindari e ata që ishën bashkë
me atë që ruajën Iisuin, kur pan

E Prëmtia e M. V. i të PARES ORE

+++++

dheun të tundej e shërbiset që stre-
ksiën, u dreruan shumë tue thënë:
vërteta Bir Perëndie isht Ki !

E ishën atjè disa gra, që vërrejën
për së largu, atò që iisuit i kishën
vatur prapa që nga galilea tue shër-
bier Atë.

Tek atò ishë Mëria Magdalenë e Më-
ria e jëma e Jakobit dhe e Josefit, edhë
e jëma e të bijëvet e Zebedheut.

tek

E TRETA ORE

Mk. XV, 16-41

Tek ai kjërò ushtarët e kjellën
Iisuin brënda te trëmeja, që isht
pretorii: e thërresiën gjithë shokjë-
rin ushtare.

E mveshiën Atë me të kukje e i vun

E prëmtia e M. V. i të TRETËS ORE

RRETH KREI Një kurorë të pleksurë me glëmba. E zun t'i faleshën tue thënë: të falemi, o Rregji i Judhenjëvet. E ja kërsesiën te kriet me kalëmin e i pushtijën e vënë mbë glunjë i bijën përmist.

E kur pra e kjeshuan, i ndsuarën të kukjen dhe e veshën me të veshurat e 'Tija, dhe e kjellën sa t'e vëjën n'krikjë.

E shtrëngojnë sa t'i kjellëj krijien Atij, një njerl; Simon Kjirineun, t'jatin e Lishëndrit e Rufit, se ish' e shkoj pse vij nga përjashta.

E bien iisuin mbi vendin Golgothà, që vien më rar vend krei.

E i jipiën të pij verë të përzieme me mirrë, por Ai ngë mori.

E posa që e vun n'krikjë; ndajtën të veshurat e 'tij tue shtur shortat mbi atò, që dò kishë nga-një të mirrëj.

E Prëmtia e M. V. i të tretes ORE

Ishë e treta orë e atà e vun n'krikjë. E ishë e shkruamja që dëftoj fajin i 'tij :Rregji i Judhenjëvet.

E me Atë vun n'krikjë dy kusarë, një tek e drejta e një tek e shtrëm bëra e 'tij. E u mbarua e shkruamia që thot: e me të paligjëjt kle Ai nëmëruar.

E atà që shkojnë atëi e nëmiën e tue tundur kriet thoshëjën: E Ti që gorromis faltoren e te tri ditë e stis, shpëtou Ti vet e sdripu nga krikjia.

Kështù edhe kriepрифtrat tue kje - shur thoshëjën njeri t'jetrit bashkë me shkruasit: ki t'jerë i shpëtou e ngë mëndë të shpëtonjë vetëhën e 'tij!

Krishti, rregji i Israelit, le t'sdrispet nga krikjia sa të shohiëm e të kemi besë tek Ai.

Edhë atà që ishën n'krikjë me Atë

+++++

e shajën. E si u bë^e gjashtëta orë u bë më t'errët mbi gjithë jetën njera tek e nëndëta orë. E mbë të nëndëlën orë Iisui shtu një thirmë të madhe tue thënë: **Ilì, Ilì lamà savahani**- çë vien më rar :Perëndi, Perëndia jim, pse më le ?

E tsa vetë nga atà çë ishën atjè, si e gjejtën, thanë: se ki thret Ilin.

E shpejt tue rriedhur një nga atà, të marrit një shpuzë, e njomi te **uthu**-lla , e vu mbi një kallëm e ja jipëj tue thënë: leni t'jesë; shohiëm në vien Ilia t'e sdripënjë.

Po Iisui me një zë të mathë **tha** shpirtin.

E shi' villi i faltores u skjuar ndysh , çë lart njera posht.

E kjindari çë rrij atjè përpara Atij, si e pa të vdisëj tue thirrur kështù, tha: **vërteta ki njeri ishë i Biri i Perëndis!**

Ishën atjè grat çë vërrejën për së largu, ndër të çilat Mëria Magdalenë, Mëria e jëma e Jakobit të vogëlit dhe e jëma e Josis e Salomia të çilat kishën vatur prapa, çë kur Ai ishë në Galilë e shumë të tjërë çë kishën jardhur me Atë nga Jerusaliimi.

tek

E GJASHTËTA ORE

Lk. XXIII, 32-49

Tek ai kjërò bashkë me Iisuin bijën edhe t'jerë dy kekjëbërësë sa t'i vrisiën bashkë me Atë.

E kur **ARRUN MBI VENDIN** çë thonë i **kreut**, atjè vun n'krikjë Atë e kekjëbëresitë, një tek e drejta e një tek e shtrëmbëra.

+++++

Iisui thëshëj: **Tate**, ndëjeji ata; se **ngë din atë** që bëjën. Pra pethkat e atij i bën pjesë pjesë e shtun shortën (kuj t'i ngisiën).

E populli rrij e vërrej. Edhë të Parët e përkjeshiën bashkë me atë tue thënë: të t'jerë i shpëtoi, le t'sh - pëtonet Ai, në isht Krishti, i sgle - dhuri i Perëndis.

E ushtarët e shajën kur i kjase - shën; e i jipiën uthullën e i thoshë - jën: në je rregji i Judhenjëvet, sh - pëtò vetëhën.

Ishë edhë një e shkruame mbi Atë grekjisht, litisht e ebraisht që thoshëj: **Ki isht rregji i Judhenjëvet.**

Një nga atë kekjëbërësë që ishën vjerrë te krikjia e nëmëj Iisuin tue thënë në Ti je Krishti, shpëtò Tij edhë ne - ve. Por ai jatri mori t'e kjërtoj e t'i thëshëj: ngë i trëmbe ti as edhë

+++++

Perëndis, se gjënde në të njëjtin mundim me Atë? E na me të drejt marriëm atë që na nget nga atë që kemi bër; por Ki mosgjë të kekjë ka bër. E Isuit i thëshëj: **Zot**, kujtou ngak u ,kur të vish te rregjéria jo - te. E Isui i tha atij: **vërteta u te thom, sot ka t'jesh me mua te Parra - isi.**

Ishë e gjashtëta orë, e u bë më t' errët mbi gjithë jetën njera tek e nëndëta orë. E dielli u err, e villi i faltores u shkjuar në mes.

E me zë të mathë Iisui thërriti e tha: **Tate, te duart t'ote u lë shpir - tin t'im.** E të thënit këtò i duall shpirti.

Si pa kjindari atë që u streks, zu të lëvdoj Perëndin, tue thënë: **vërte - ta Ki njeri ishë i drejt.**

E gjithë atò gjinde që atjè bash - kë kishën jardhur për të vërrejtur

këtë punë, të parit këto shërbise
çë streksiën, prireshën tue rrahur
gjirin e vet.

Për së largu rrijën e vërrejën kë-
to shërbise gjithë atà çë iisuin e
njihiën e grat çë i kishën vatur
prapa bashkë nga Galilea.

tek

E NËNDËTA ORË

Tek ai kjërò, kur ata e patën vënë
n'krikjë Iisuin; muartin pethkat e
'tij, i bën katrë pjesë, një pjesë
nga ushtar, e rrobikurn:

Ishë ki rrobik pa kjepur, ler gji-
thënjëi tsopie çë lart njera posht.

Andai atà thanë ndë 'ta: mos e sh-
kjlërriëm, po: shtiem shortën kuj
t'i ngasënjë: sa t'ishë mbaruar e
shkruamia: ndajtën ndë 'ta pethkat
t'ime, e mbi rrobikun t'im shtun

E Prëmptia e M. V. itë IX ORE

shortën.

Andai këto shërbise bën atà ushta-
rë.

Shtuara afër krikjies t'Iisuit rrijën e
jëna e 'Tij, e motra e së Jëmës s'Tij, Maria
e Kleofës edhë Mëria Magdalenë.

E Iisui, si pa të Jëmën e atjè nd'
anëzë Asaj dsënësin çë Ai dej mirë,
i thot të Jëmës: **Grua**, shi' jit
bir. I thot pra dsënësit: shi' jot
Emë. E çë tek ajo herë Ki e mori
bashkë si e 'tija.

Andai të klënit çë ndëlgoi Iisui
se gjithkjish u kishën sosur, sa të
sosej e Shkruamia, Ai tha: **kam etë**.
Ishë edhë atjè një poçe e plotë me
uthullë: e atà ushtarë muartin e njo-
mën një shpuzë plot te uthulla dhe e
vun mbi një degë isopi e ja kjasën
te goja Iisuit.

Kur pra Iisui mori uthullën, Ai
tha: **sosi**. E të ujurit kriet, dhe shpirtin.

Judherjtë pra ,pse ishë e Prëptia,sa mos t'kjëndrojën mbi krikjien ata kur-me tek e Shtunia-posa ajo ishë di-ta e së shtunies s'madhe-i lipën Pilatit sa t'i çaheshën këmbët e të ndsireshën nga krikjia.

Jerdhën andai ushtarë e të parit i çajtën këmbët e ashtu t'jatrit që kle krikjëzuar bashkë me Atë.

Por të jardhurit tek Iisui,si e pan të vdekur,ngë ja çajtë këmbët.

Po një nga ushtarët me shtizën e 'tij i shpoi brinjën e i duall një-therie **gjak e ujë**

E kush e pa bë deshmi e martiria e 'tij isht e vërtetë. E ai di se thot të vërtetën:sa ju të kini be-së.

Po këto shërbise pra klen,sa të mbaronet e shkruamia: **Një asht Atij ngë ka t'i çahet.**

E pameta jatra e shkruame thot:
Kanë të vën 're mbi Atë që shpuan.

